



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia për Barazi Gjinore / Agencija za Ravnopravnost Polova /
Agency of Gender Equality

Vlerësimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore

2008 - 2013

Dhjetor 2016



EMBASSY OF SWEDEN



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia për Barazi Gjinore / Agencija za Ravnopravnost Polova /
Agency of Gender Equality

Vlerësimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore

2008 - 2013

Dhjetor 2016



EMBASSY OF SWEDEN

Mbështetur nga projekti “Fuqizimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Mekanizmave Gjinor” Projekt i financuar nga “Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar- SIDA”
Konsorciumi implementues:

Vlerësimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjimore 2008 - 2013

Dhjetor 2016

PARATHËNIE

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013 – PKBGJ, është politika e parë publike hartuar nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës (ABGJ), me përfshirje të gjerë të institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile, partnerëve vendorë dhe ndërkombëtar për një agjendë kombëtare për avancimin e barazisë gjinore. Ky dokument i rëndësishëm, hartimi i të cilit është detyrim ligjor sipas Ligjit për Barazi Gjinore, dhe bazuar në këtë ligj u aprovua përmes një rezolute nga Kuvendi i Kosovës.

Dokumenti filloj të hartohet në vitin 2007, dhe u miratua në Republikën e sapo shpallur të Kosovës, në prill të vitit 2008, me vendimin Nr 07/17 24/04/2008. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore ishte një produkt i një konsensusi politik, për ta avancuar barazinë gjinore si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe ndërtimit të demokracisë.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, ishte një dokument strategjik ambicioz për kohën, i cili mbulojë pothuajse të gjitha fushat e jetës publike, dhe në zbatim u përball me sfida të shumëfishta, por pavarësisht prej tyre shënoi arritje të cilat i kemi paraqitur në këtë vlerësim që sot po e ofrojmë para publikut të Kosovës dhe partnerëve tanë. Duhet theksuar se ky dokument ishte një dokument pararendës i politikave tjera, që u hapi rrugën dhe vendosi vizionin për politika gjithëpërfshirëse, e po ashtu dhe për grup të veçanta. Nën ombrellën e këtij Programi vepruan dhe u krijuan mekanizma institucionale të natyrave dhe funksioneve të ndryshme, në të gjitha nivelet e qeverisjes, në nivel qendror dhe komunal.

Në emër të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Qeverisë së Kosovës gjej rastin të shpreh falenderimin për institucionet e Kosovës, në mënyrë të veçantë për zyrtaret/ët për barazi gjinore në ministri dhe komuna që diku më shumë dhe diku më pak arritën që perspektivën gjinore ta bëjnë pjesë integrale të prioritetëve ku ato/a veprojnë. Shpreh mirënjohjen për të gjithë partnerët ndërkombëtarë dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme për shënimin e progresit në avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. Ndaj respektin për shoqërinë civile për kontributin, kurajon dhe përkushtimin për hartimin dhe zbatimin e Programit, në të gjithë vendin. Falenderoj ekspertët që kanë ofruar ekspertizën e tyre në të gjitha statet e Programit dhe kanë mundur zbatimin cilësor të aktiviteteve të suksesshme të këtij Programi.

Gjej rastin të falenderoj Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar – SIDA, me mbështetjen e së cilës u realizua ky vlerësim.

Sinqerisht,


Edi Gusia
Agjencia për Barazi Gjinore
Zyra e Kryeministrit
Prishtinë 2017

Përmbledhje ekzekutive

Një nga politikat kyçe që synon të mbyll boshllëkun mes burrave dhe grave është Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ), i cili është hartuar nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës (ABGJ) dhe si e tillë është e vetmja politik publike që duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës përmes një rezolute. Deri më tani, Agjencia ka hartuar dhe zbatuar PKBGJ-në e parë e cila ka mbuluar periudhën nga 2008 deri më 2013. Objektivat e PKBGJ janë të organizuara sipas fushave programatike në vijim: a) Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e gruas; b) përmirësimi i qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësor, c) qasja dhe shërbime cilësore shëndetësore për gra dhe vajza; d) fuqizimi ekonomik i grave; e) përmirësimi i gjendjes sociale i grave në rrezik; f) punësimi i grave dhe vajzave; përmirësimi i imazhit të grave në media, sport dhe kulturë; dhe g) pjesëmarrja dhe përfaqësimi i barabartë i të dy gjinive në procesin e vendimmarrjes.

Në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Barazi Gjinore të Kosovës në lidhje me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin periodik mbi zbatimin e politikave publike të Kosovës nga perspektiva e barazisë gjinore dhe zotimin e ABGJ që të mësoj nga përvojat e mëhershme, objektivi i përgjithshëm i këtij vlerësimi është që të përcaktoj se deri në çfarë shkalle është arritur progresi në periudhën mes vitit 2008 deri 2013 sa i përket përmbushjes së objektivave të PKBGJ si dhe të vlerësoj statusin e zbatimit të secilit nga aktivitetet e përfshira në PKBGJ. Ky vlerësim është mundësuar nga projekti “Fuqizimi Institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Mekanizmave Gjinor” që financohet nga “Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – SIDA”

Vlerësimi është realizuar në përputhje me parimet, standardet dhe praktikat të cilat i respektojnë standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare ashtu siç janë formuluar në kuadër të Vlerësimit të Parimeve të OBZHE. Është përdorur një gamë e gjerë e metodave për të siguruar informata për këtë vlerësim. Diskutimet e grupeve të fokusit me Zyrtar të Barazisë Gjinore (ZBGJ) në radhët e Ministrive dhe Komunave si dhe intervistat e gjysmë-strukturuara me disa nga ZBGJ, përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile si dhe donatorëve kanë siguruar të dhënat parësore për këtë vlerësim. Për më tepër, informata të rëndësishme janë marrë edhe nga Buletini i ABGJ, statistikatat zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ministritë relevante si dhe nga studimet hulumtuese të ABGJ, donatorëve dhe OSHC-ve lokale.

Është me rëndësi të theksohet se ekzistojnë dy kufizime kyçe/të gjera të cilat e kanë penguar këtë vlerësim, e të cilat duhet pasur parasysh gjatë leximit të gjetjeve që dalin nga ky vlerësim. E para është që ky vlerësim është realizuar pas afër 3 vite nga përfundimi i periudhës zbatuese të PKBGJ, dhe duke ditur mungesën e monitorimit të PKBGJ dhe memories së kufizuar institucionale ka gjasa që progresi i raportuar në këtë vlerësim të jetë i nën-vlerësuar; ndërsa kufizimi i dytë rrjedh nga dizajni i kornizës së PKBGJ, më saktësisht: a) mungesa e ndërlidhjes së drejtpërdrejt mes analizës së kontekstit, objektivave dhe aktiviteteve shoqëruese; b) mungesa e të dhënave fillestare dhe indikatorëve përfundimtar për shumë nga objektivat dhe aktivitetet, të cilat e pengojnë vlerësimin e duhur të progresit të arritur me kalimin e kohës; si dhe c) ndërlidhja e kufizuar e aktiviteteve për institucionet përgjegjëse dhe mungesa e vlerësimit të buxhetit për secilin aktivitet.

Ky vlerësim konfirmon se PKBGJ-ja ka qenë një dokument relevant pasi që identifikonte sfidat kryesore të cilat e pengonin barazinë gjinore në Kosovë. Gjatë ciklit jetësor të PKBGJ-së, janë zhvilluar disa strategji si dhe janë themeluar disa mekanizma të ri institucional, duke synuar kështu të kontribuojnë në kuadër të agjendës për barazi gjinore në Kosovë. Pavarësisht progresit që është arritur në disa nga treguesit e tregut të punës dhe atyre socio-ekonomik, deri në vitin 2013 grat në Kosovë kanë qenë në pozitë më të pa-favaroshme në krahasim me burrat.

Disa përmirësime janë evidentuar në objektivat e ndërlidhura me shëndetin, përkatësisht në: a) normat e mortalitetit të foshnjave dhe nënave, b) ndërgjegjësimin dhe ofrimin e programeve të ekzaminimit për kancerin e gjirit, dhe c) promovimin dhe përdorimin e shërbimeve të planifikimit familjar. Megjithatë, nuk është evidentuar arritja e ndonjë progresi në ofrimin e vaksinimit pa pagesë

për HPV dhe programeve të ekzaminimit për kancerin cervikal, si dhe barazia gjinore nuk është inkomporuar në kurrikulën dhe syllabusin e arsimit të lartë ashtu siç ishte planifikuar.

Progres i dukshëm është arritur gjatë zbatimit të PKBGJ-së në lidhje me sigurimin e kornizës politike (politikat ligjore dhe publike në formën e strategjive dhe planeve të veprimit) për të adresuar fenomenin e dhunës në familje në Kosovë. Gjithashtu, trajnimet e personelit të institucioneve kyçe dhe ndryshimet në mekanizmat dhe sistemet institucionale të cilat kërkoheshin nga dokument i PKBGJ janë inkomporuar në politikat publike kundër dhunës në familje, dhe si të tilla ishin ofruar nga ABGJ, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), OSHC-të lokale dhe nga komuniteti i donatorëve. Megjithatë, vlerësimi arrin në përfundimin se ka pasur mungesë të programeve të orientuara drejt reintegrimit të të mbijetuarve të dhunës në familje.

Po ashtu, vlerësimi konkludon se gjatë periudhës nga viti 2008 deri në vitin 2013, në sektorin e arsimit, është përmirësuar norma e regjistrimit dhe vijueshmërisë së vajzave në shkollë. Megjithatë, gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ ende mbizotëronin dallimet gjinore, ku vajzat ishin të nën-përfaqësuar në arsimin e mesëm të lartë dhe në arsimin parashkollor. Megjithëse, ka pasur një progres të lehtë, stafi akademik në institucionet publike të arsimit të lartë ende vazhdon të dominohet nga burrat. Stereotipat gjinore vazhdojnë të mbeten të pranishme në tekstet shkollore dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nuk ka ndërmarr asnjë veprim që të adresoj ekzistimin e tyre në tekstet shkollore.

Të dhënat e analizuar në kuadër të këtij vlerësimi sa i përket pjesëmarrjes dhe përfaqësimit tregojnë se numri i grave të zgjedhura gjatë zgjedhjeve parlamentare dhe lokale është rritur si për Kuvendin e Kosovës ashtu edhe për asambletë komunale. Megjithatë, përfaqësimi i grave të Kosovës në pozitave vendimmarrëse në ministrinë e linjës dhe komunat e Kosovës ishte larg arritjes së kërkesës prej 40 përqind të përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore të vitit 2004. Deri në vitin 2013, vetëm shtatë përqind e pozitave vendimmarrëse në ministrinë e linjës dhe katër përqind në komuna mbaheshin nga gratë. Gratë përbënin 10 përqind të pozitave vendimmarrëse në Policinë e Kosovës dhe vetëm 6.3 përqind të pozitave vendimmarrëse në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Stereotipat gjinore kanë vazhduar të ekzistojnë edhe në media, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së PKBGJ-së. Megjithëse nuk janë bërë përpjekje të koordinuara sa i përket aktiviteteve në këtë fushë, iniciativat janë marr nga institucionet e Kosovës dhe OSHC-të lokale, kryesisht përmes realizimit të hulumtimeve, prezantimit të kornizave të reja dhe ngritjes së vetëdijes. Megjithëse nuk ka dëshmi për diskriminim ndaj grave gazetarë, të dhënat zbulojnë se pozitave vendimmarrëse mbahen kryesisht nga burrat dhe nuk janë marr hapa konkret për të ndryshuar përfaqësimin e tyre.

PKBGJ-ja e ardhshme duhet të siguroj një përafrim të sfidave të identifikuar të cilat e pengojnë barazinë gjinore me objektivat dhe aktivitetet e inkomporuara në program. Ngjashëm, duhet bërë një vlerësim të kapaciteteve të mekanizmave institucional të mandatuar që të sigurojnë barazinë gjinore, ndërsa aktivitetet specifike për të i avancuar ato duhet të përfshihen në program; PKBGJ-ja duhet të përshtatet duke u bazuar në dizajnin dhe kornizat për zbatim të bazuara në rezultate. Për më tepër, ajo duhet të shoqërohet me indikator specifik dhe të matshëm të gjendjes fillestare dhe atyre të targetuar si dhe duhet caktuar linja të qarta të institucioneve përgjegjëse dhe buxhetin për secilin aktivitet. Në fund, duhet përcaktuar mekanizmat e koordinimit ndër-institucional me përgjegjësi të qarta dhe të njëjtit duhet të bëhen funksional përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të PKBGJ-së.

Përmbajtja

1.Hyrje	13
2.Qëllimi dhe metodologjia e vlerësimit	14
2.1 Kufizimet e këtij vlerësimi	16
3.Gjetjet kryesore	18
3.1Rëndësia dhe koherenca e objektivave të PKBGJ-së	18
3.1.1 Inputet gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së	20
3.2.1 Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike	23
3.2.2 Shëndetësia	26
3.2.3 Dhuna në familje	27
3.2.4 Stereotipat	31
3.2.5 Arsimi	32
3.2.6 Pjesëmarrja dhe përfaqësimi	34
3.2.7 Gratë në media	36
3.3 Ndikimi i PKBGJ-së	37
3.3.1 Vlerësimi i strukturave koordinuese dhe sistemeve të monitorimit	38
3.4 Qëndrueshmëria e gjinisë si çështje ndër-sektorale në politikat publike të Qeverisë së Kosovës ..	40
4. Përfundimet, mësimet e nxjerra/rekomandimet për PKBGJ-në e ardhshëm	43
4.1 Vërejtjet përfundimtare.....	43
4.2 Mësimet e nxjerra/.rekomandimet për PKBGJ-në.e ardhshëm.....	45
Referencat	46
Shtojca 1: Treguesit të gjendjes fillestar dhe përfundimtare të PKBGJ-së: Treguesit e gjendjes fillestare të nxjerrë nga analiza e kontekstit të Programit	48
Shtojca 2: Lista e personave të intervistuar	52
Shtojca 3: Objektivat lidhur me b arazinë gjinore në dokumentet strategjike kombëtare të zhvilluar/mbulojnë periudhën 2008-2013	53

Shkurtesat dhe akronimet

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
UA	Udhëzim Administrativ
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
KE	Komisioni Evropian
ZBGJ	Zyrtarët për Barazi Gjinore
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
PK	Policia e Kosovës
PKBGJ	Plani i Kosovës për Barazi Gjinore
RRGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LGBT	Lezbike, Gej, biseksualë dhe transgjinorë
MIE	Ministria e Integritit Evropian
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NDI	Instituti Demokratik Kombëtar
ODA	Ndihma Zyrtare për Zhvillim
ZPP	Zyrtat Publike të Punësimit
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QGMK	Qendra për Mediat e Grave të Kosovës

1. Hyrje

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore është hartuar nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore të Kosovës (ABGJ), me përfshirje të gjerë të partnerëve kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe është e vetmja politik publike e cila është obligative sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe që kërkohet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës përmes një rezolute. Deri më tani, Agjencia ka miratuar dhe zbatuar Programin e parë të Kosovës për Barazi Gjinore që ka mbuluar periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2013. Plani mbulon tetë objektiva që bien në fushat e mëposhtme programatike:

1. Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e gruas;
2. Rritja e qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësor;
3. Qasja dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore për gra dhe vajza;
4. Fuqizimi ekonomik i grave;
5. Përmirësimi i situatës sociale të grave në rrezik;
6. Përmirësimi i punësimit për gratë dhe vajzat
7. Përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport; dhe
8. Pjesëmarrje dhe përfaqësim i barabartë i të dy gjinive

Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës kërkon monitorim, vlerësim dhe raportim periodik mbi zbatimin e politikave publike të Kosovës nga perspektiva e barazisë gjinore. ABGJ-ja është aktori kryesor për realizimin e këtyre veprimeve dhe përhapjen e gjetjeve tek të gjitha institucionet shtetërore, partnerët dhe shoqërinë në përgjithësi, duke synuar avancimin e barazisë gjinore në Kosovë dhe adresimin e sfidave të ndërlidhura me barazinë gjinore. Prandaj, vlerësimi i PKBGJ kërkon të përcaktoj progresin e arritur gjatë periudhës 2008 deri më 2013 në fushën e barazisë gjinore dhe të gjeneroj njohuri mbi pengesat të cilat kanë ndaluar progresin e barazisë gjinore në Kosovë. Gjithashtu, ky vlerësim është një aktivitet i rëndësishëm për mësim nga palët e përfshira, të cilat do e informonin zhvillimin e dokumentit të ri të PKBGJ.

Vlerësimi është realizuar në përputhje me parimet, standardet dhe praktikën të cilat i respektojnë standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare ashtu siç janë formuluar në kuadër të Parimeve të Vlerësimit të OBZHE. Periudha e raportimit mbulon ciklin jetësor të PKBGJ-së, megjithëse për shkak të disponueshmërisë janë bërë disa referenca ndaj statusit të treguesve në vitin 2014. Raporti është strukturuar si më poshtë: Kapitulli 2 e vë në pah metodologjinë e aplikuar të ndjekur nga elaborimi i kufizimeve të vlerësimit, të paraqitur në Seksionin 2.1. Gjetjet kryesore janë paraqitur në Kapitullin 3, dhe përbëhen nga: efektiviteti i intervenimeve; vlerësimi i ndikimit, dhe qëndrueshmëria e ndikimit. Në përputhje me termat e referencës, vlerësimi i efektivitetit fokusohet në punësim, fuqizimin ekonomik, arsim, dhunën në familje, shëndetin dhe ndikimin e përfaqësimit të grave në media. Raporti përfundon me një përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe nxjerr mësim për të informuar zhvillimin e një Programi të ardhshëm të Kosovës për Barazinë Gjinore

Historiku i zhvillimit të PKBGJ

Procesi i zhvillimit të PKBGJ 2008-2013 ka filluar në vitin 2007, në kohën kur Kosova ishte nën administrimin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) – një administratë e përkohshme/tranzicionale që është përgjegjëse për krijimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve demokratike të përkohshme vetë-qeverisëse për të siguruar kushtet për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës. PKBGJ-ja është miratuar në muajin prill të vitit 2008, dy muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Zhvillimi i PKBGJ-së ishte obligim që rezultonte nga Ligji Nr. 2004/2 mbi Barazinë Gjinore (Neni 2¹); kjo ishte në përputhje me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër

¹ Qeveria harton Programin e Kosovës për Barazi Gjinore kurse Kuvendi i Kosovës shqyrton dhe miraton Rezolutën për Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

grave (CEDAW) që është e përfshirë në Kushtetutën e Kosovës (Neni 3²); si dhe i respekton objektivat për Integrim Evropian dhe Synimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit (PKBGJ 2008-2013; fq. 101)

2. Qëllimi dhe metodologjia e vlerësimit

Në përputhje me Termat e Referencës për këtë vlerësim, Agjencia për Barazi Gjinore po planifikon të zhvillojë një Program të ri të Kosovës për Barazi Gjinore. Nevojitet një vlerësim i jashtëm për të konstatuar ndikimin e PKBGJ 2008-2013, për të kuptuar më mirë përparësitë dhe dobësitë e zbatimit të tij, me qëllim të përshtatjeve të mëtejme dhe zhvillimit të programit të ri. Rëndësia e këtij aktiviteti qëndron në nevojën që procesi të shfrytëzohet për nxjerrjen e mësimave nga palët e përfshira, si dhe të çuar drejt një mjeti më efektiv në zhvillimin e dokumentit të PKBGJ të ri për pesë vitet e ardhshme. Më tej, Agjencia dhe partnerët e saj besojnë që gjetjet e këtij vlerësimi do t'i kontribuojnë vendimmarrjes më të informuar, do të nxisin një mjedis të të mësuarit nga praktika, si dhe do të promovojnë llogaridhënie më të madhe në lidhje me performancën e të gjithë akterët e përfshirë në planifikimin dhe zbatimin e PKBGJ të ri, i cili do të hartohet gjatë muajve në vijim.

Objektivi i përgjithshëm i këtij vlerësimi është që të përcaktojë shkallën e përparimit të shënuar ndërmjet viteve 2008 dhe 2013 drejt përmbushjes së vizionit të PKBGJ-së të shprehur në dokument, i cili thotë që "Kosova do të jetë vendi ku të gjitha burrat dhe gratë do të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje, do të gëzojnë të drejta të barabarta në arsim dhe punësim, si dhe qasje të lirë e të barabartë në të gjitha shërbimet publike, në mënyrë që të mund të gëzojnë rezultatet e punës së tyre."

Fushëveprimi dhe përqendrimi

Fushëveprimi i këtij vlerësimi mbulon të gjitha fushat e identifikuara të programit, si dhe arritjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme të tyre, sikundër përcaktohet në dokumentin e PKBGJ 2008-2013. Fushat e përcaktuara në PKBGJ janë si në vijim:

- Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, i mbrojnë të drejtat e grave dhe i fuqizojnë ato,
- Qasja e grave dhe vajzave në arsim cilësor
- Qasja dhe shërbimet cilësore shëndetësore për gratë dhe vajzat,
- Fuqizimi ekonomik i grave,
- Përmirësimi i gjendjes sociale të grave të rrezikuara,
- Punësimi për gratë dhe vajzat,
- Përmirësimi i imazhit të grave në media, sport dhe kulturë,
- Pjesëmarrja e barabartë dhe përfaqësimi i të dyja gjinive në procesin e vendimmarrjes.

Siç është përvijuar në pjesën paraprake, ky vlerësim ndjek parimet, standardet dhe praktikën, duke respektuar standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të formuluar në Parimet e Vlerësimit të OBZHE-së dhe në përputhje me detyrat e përkufizuara në kuadër të TeR për këtë vlerësim. Në kuadër të katër komponentëve kryesorë të vlerësimit janë adresuar pyetjet specifike në vijim.

Vlerësimi i relevancës:

- Nëse ishin relevante objektivat e PKBGJ-së, logjika dhe koherenca, si dhe ndikimi i tyre i synuar dhe i arritur për secilin objektiv,

Vlerësimi i efikasitetit:

- Vlerësimi i shkallës në të cilët objektivat dhe aktivitetet në kuadër të PKBGJ-së janë arritur dhe zbatuar;

Vlerësimi i eficiencës:

- Vlerësimi se sa burimet e financimit, personelit, ato rregullative, administrative, kohore dhe të tjera i kanë kontribuar ose kanë penguar arritjen e rezultateve;

² Përcakton se "Shtetet Palë do të marrin masat e duhura në të gjitha fushat, në veçanti në fushat politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, përfshirë legjislationin, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave, me qëllim të u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimi e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat"

Vlerësimi i ndikimit:

- Në çfarë shkalle dhe mënyre ka përmirësuar zbatimin e PKBGJ-së gjendjen e grave dhe burrave në Kosovë, veçanërisht të grave;

Vlerësimi i qëndrueshmërisë:

- Shqyrtimi i qëndrueshmërisë së çështjeve gjinore si çështje ndër-sektoriale në politikat publike të Qeverisë së Kosovës, pra vlerësimi nëse rezultatet e strategjisë përfshirëse gjinore mund të mbahen në kohë.

Kriteret shtesë që duhet vlerësuar aq sa është e mundur janë si në vijim:

- a) Përfshirja gjinore dhe masat e veçanta për gratë:
 - Sa kanë kontribuar metodat e përdorura për përfshirjen e gjinisë (veçanërisht: shqyrtimi i politikave dhe udhëzimeve ekzistuese, përdorimi i statistikave dhe indikatorëve, konsultimi aktiv i akterëve, etj.) për ta bërë çështjen gjinore të dukshme në politikat publike, bazat e të dhënave dhe analizat në Kosovë?
 - Sa kanë ndikuar pozitivisht masat pozitive ose veprimet afirmative për gratë në promovimin e barazisë gjinore në shoqërinë kosovare? Çfarë masash pozitive/veprimesh afirmative janë ndërmarrë gjatë periudhës së PKBGJ 2008-2013 dhe çfarë ndikimi kanë pasur në statusin e grave?
 - Çfarë mekanizmesh gjinorë janë themeluar gjatë PKBGJ-së? A janë përkrahur financiarisht dhe institucionalisht dhe çfarë arritjesh mund të përmenden deri më sot? Sa të qëndrueshëm dhe eficientë janë këta mekanizma aktualisht?
- b) Strukturat koordinuese dhe sistemet monitoruese të PKBGJ-së
 - Çfarë mekanizmesh koordinues janë krijuar për zbatimin efektiv të koordinuar të PKBGJ-së? Me sa efikasitet e kanë koordinuar ata zbatimin e tij dhe sa kanë ndikuar në ndarjen e burimeve vit pas viti për aktivitetet e parapara të PKBGJ-së? Çfarë ka ndikuar pozitivisht ose negativisht në funksionimin e strukturave koordinuese të PKBGJ-së? A janë përkufizuar qartë rolet dhe mandatat e tyre? Çfarë e ka përmirësuar dhe çfarë e dobëson funksionimin e strukturave të tilla?
 - Sa ka qenë efikas sistemi monitorues i PKBGJ 2008-2013 dhe a ka qenë i qasshëm nga të gjitha palët e përfshira? A janë mbajtur trajnime mbi përdorimin e sistemit monitorues për të gjitha palët e përfshira dhe çfarë mjetesh janë dizajnuar dhe përdorur gjatë këtij procesi? Çfarë pengesash janë vërejtur gjatë procesit monitorues të PKBGJ-së?

Metodologjia e vlerësimit

Natyra e nismave të politikave kombëtare, ndër-sektoriale dhe horizontale të tilla si Programi i Kosovës për Barazi Gjinore kërkon përdorimin e një sërë metodash dhe mjetesh për vlerësimin e zbatimit të tij strategjik dhe operativ në nivel të qeverisë qendrore dhe lokale, si dhe ndikimin e tij në jetën e grave dhe burrave në Kosovë. Rrjedhimisht, ndërmjet shtatorit dhe dhjetorit 2016 u përdorën një varg metodash për të mbledhur të dhëna për vlerësimin, duke përfshirë:

- Shqyrtimin e dokumenteve kyçe të sfondit;
- Intervistat gjysmë të strukturuar me akterët; dhe
- Diskutimet me fokus grupe.

Burimet parësore të të dhënave

Janë realizuar dy diskutime me fokus grupe me ZBGJ nga ministritë dhe komunat. Diskutimet kishin për qëllim të vlerësonin relevancën dhe koherencën e objektivave të PKBGJ-së për të mbledhur informata të përgjithshme mbi aktivitetet e realizuara nga ministritë dhe komunat, si dhe mbi buxhetin e ndarë për realizimin e intervenimeve që ndërlidhen me PKBGJ-në. Pas këtyre diskutimeve me fokus grupe, ZBGJ-ve të ministrive iu dërgua një formular i raportimit, ku ata duhej të evidentonin aktivitetet e ndërmarra gjatë periudhës së PKBGJ-së, si dhe të raportonin mbi përmbushjen e indikatorëve të përcaktuar në pjesën përkatëse të Planit të Veprimit të PKBGJ-së. Gjithashtu u përpilua një listë e pyetjeve për të mbledhur informata nga ZBGJ-të komunale lidhur me fushat programore të PKBGJ-së. Këto institucione vendosën të përgjigjen: Ministria e Arsimit,

Shkencës dhe Teknologjisë (por jo për të gjithë indikatorët); Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (nuk ofroi të dhëna të plota mbi skemat e granteve dhe përfituesit e trajnimeve); Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Infrastrukturës; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (nuk ofroi të dhëna të plotë mbi përfituesit e Politikave Aktive të Tregut të Punës dhe familjet me kryefamiljare femra që merrnin asistencë sociale); Ministria e Integritetit Evropian ofroi të dhëna financiare mbi mbështetjen e donatorëve për fushën e barazisë gjinore; Agjencia Kadastrale e Kosovës ofroi të dhëna mbi përqindjen e pronave të regjistruara në emër të grave; si dhe komuna e Lipjanit, Malishevës, Mitrovicës, Obiliqit, Prishtinës, Prizrenit, Suharekës dhe Vitisë.³

Në fund, u mbajtën intervistat gjysmë të strukturuar me KWN, UN Women, Women for Women dhe UNFPA, me qëllimin që të merren opinionet e tyre lidhur me relevancën e PKBGJ-së, koherencën e objektivave të PKBGJ-së, këndvështrimin e tyre mbi ndikimin e intervenimeve që ndërlihen me PKBGJ-në dhe eficiencën e tyre, për të kuptuar vlerësimin e tyre të qëndrueshmërisë së gjinisë si çështje e përgjithshme në politikat qeveritare, si dhe për të mbledhur informata mbi ekzistencën dhe performancën e strukturave koordinuese dhe sistemeve monitoruese të PKBGJ-së.

Të intervistuarit dhe pjesëmarrësit e fokus grupeve u siguruan që përgjigjet dhe opinionet e tyre do të ishin anonime dhe që informatat e marra gjatë intervistave dhe fokus grupeve do të përdorshin në mënyrë konfidenciale dhe do të ruheshin në mënyrë të sigurt.

Burimet e të dhënave dytësore

U shqyrtuan raportet ekzistuese kombëtare dhe studimet në fushat që ndërlihen me PKBGJ-në, ku nga ky shqyrtim u mbledhën të dhëna lidhur me statusin e indikatorëve përfundimtarë (shtojca 1), të cilët po ashtu shërbyen si burim parësor për identifikimin e ligjeve të reja, dokumenteve strategjike dhe mekanizmave të zhvilluar gjatë periudhës së PKBGJ 2008-2013. Informatat e vlefshme mbi progresin e shënuar në fushat programore të PKBGJ-së u mbledhën nga raportet vlerësuese të strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit të zbatuara gjatë ciklit jetësor të PKBGJ-së. Meqenëse objektivat dhe aktivitetet e PKBGJ-së nuk ishin të kuantifikuara, ë, të dhënat e ofruara në analizën e kontekstit të PKBGJ-së u përdorën si nivel fillestar për të vlerësuar efikasitetin e PKBGJ-s, si dhe u bënë krahasime me 2013 kurdo që të dhënat ishin në dispozicion.

Informatat mbi aktivitetet e ndërmarra nga ABGJ dhe ZBGJ-të e ministrive dhe komunave u morën nga Buletini i ABGJ-së dhe nga raportet e rregullta periodike të ofruara për këtë vlerësim nga ZBGJ-të. Për të përmbledhur intervenimet e bëra nga OSHC-të në fushat programore të PKBGJ-së, u përdorën informatat nga organizatat e shoqërisë civile të dërguara në formë të raporteve vjetore dhe hulumtimeve për mbledhjen e informatave të mëtejme dhe vërtetimin e dëshmimeve.

Bazuar në burimet parësore dhe dytësore të të dhënave, statusi i zbatimit të secilit prej aktiviteteve të PKBGJ-së është dhënë në shtojcën 4.

2.1 Kufizimet e këtij vlerësimi

Ky vlerësim është komisionuar rreth tre vjet pas përfundimit të periudhës zbatuese të PKBGJ-së. Kjo pjesë flet për kufizimet e këtij vlerësimi:

- Rezultatet e prezantuara në këtë vlerësim priren të jenë të nënvlerësuara për shkak të mungesës së monitorimit ose monitorimit të pamjaftueshëm të zbatimit të PKBGJ-së. Më tej, vlerësimi është dashur të bazohet jashtëzakonisht shumë në kujtesën individuale të shërbyesve civilë për shkak të kujtesës së kufizuar institucionale si pasojë e raportimit të dobët dhe mungesës së dokumentimit të duhur të zbatimit të aktiviteteve të PKBGJ-së, para së gjithash nga ana e institucioneve qeveritare;
- Kufizimet e vlerësimit të PKBGJ-së gjithashtu burojnë nga dizajni i kornizës së PKBGJ-së, të cilit i mungojnë objektivat e veçanta dhe të matshme, si dhe indikatorët e synuar për nën-objektivat dhe aktivitetet e planifikuara;
- Mungesa e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet analizës së kontekstit/sfidave; objektivave; masave/aktiviteteve; dhe indikatorëve;
- Disa objektiva ishin shumë optimiste, gjë që dërgoi në zbatim të kufizuar të tyre;
- Indikatorët për objektivat dhe aktivitetet ishin të përkufizuar dobët, gjë që pengoi vlerësimin

³ Komunitat e tjera nuk u përgjigjën në kërkesën e raportimit për këtë vlerësim

- e progresit;
- Mungesa e indikatorëve të nivelit fillestar për objektivat dhe aktivitetet, kundrejt të cilëve do të matej progresi. Për disa indikatorë të gjendjes fillestare, nuk ishte e qartë si ishin përpiluar dhe nuk ishte dhënë asnjë referencë për burimin e të dhënave, prandaj ishte e pamundur që vlerësimi të bënte një krahasim të drejtpërdrejtë të tyre me rezultatet përfundimtare të arritura;
- Për disa prej aktiviteteve të parapara, mungonte institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të parashikuara, gjë që ishte sfidë e vazhdueshme gjatë mbledhjes së informatave për këtë vlerësim.

Gjatë vlerësimit, në përputhje me kërkesat e TeR, u bënë përpjekje që të merreshin të dhëna financiare mbi aktivitetet e kryera nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal gjatë zbatimit të PKBGJ-së. Fatkeqësisht, informata të tilla nuk u ofruan nga subjektet përgjegjëse, prandaj kontributet financiare për zbatimin e PKBGJ-së nuk mund të vlerësohen saktësisht. Megjithatë, ky aspekt analitik mungon në shumicën e raporteve vlerësuese dhe monitoruese në Kosovë, duke përfshirë raportin e vlerësimit të Strategjisë kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014, dy raportet e monitorimit të zbatimit të Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria", raportin e monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014, si dhe në Raportin e Vlerësimit 2011-2016 të **PSAK**.

Ky vlerësim ofron të dhëna të pjesshme mbi numrin e grave përfituese të programeve të fuqizimit ekonomik, pasi që të njëjtat nuk u ofruan nga ministritë përkatëse, përkatësisht MTI dhe MBPZHR. Gjithashtu duhet theksuar që vetëm një ZBGJ nga komunat serbe mori pjesë në diskutimin me fokus grupe të organizuar për këtë vlerësim.

Për të përmbledhur, ky vlerësim duhet të lexohet në kontekst të këtyre kufizimeve. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet që për shkak të kufizimeve të PKBGJ-së dhe mungesës së monitorimit të duhur dhe me kohë të PKBGJ-së, progresi i arritur gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ-së nuk mund t'i atribuohet vetëm PKBGJ-së.

3. Gjetjet kryesore

3.1 Rëndësia dhe koherenca e objektivave të PKBGJ-së

Fokusi i këtij seksioni është vlerësimi i rëndësisë së PKBGJ-së dhe vlerësimi nëse nën-objektivat dhe aktivitetet e PKBGJ-së kanë qenë në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe qëllimin e përgjithshëm të PKBGJ-së.

Deklarata e misionit të PKBGJ-së ishte *Kosova do të jetë vendi ku të gjithë qytetarët dhe qytetarët do të kenë mundësi për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje, si dhe të drejta të barabarta, në shkollim, punësim, qasje të lirë dhe të barabartë në të gjitha shërbimet publike, në mënyrë që të gëzojnë rezultatet e punës së tyre*. Ky mision është paraparë që të arrihet nëpërmjet ndjekjes së objektivave të veçanta strategjike: 1) përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e gruas; 2) rritja e qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësor; 3) përmirësimi i shëndetit të vajzave dhe grave duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të tyre; 4) fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave; 5) përmirësimi i situatës sociale të grave në rrezik, nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre në shërbime sociale cilësore; 6) Përmirësimi i treguesve të punës për gratë dhe vajzat; dhe 7) përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport.

A kanë qenë të rëndësishme objektivat e PKBGJ-së?

Bazuar në intervistat e kryera në kuadër të këtij vlerësimi, marrëveshje e përgjithshme është se PKBGJ ka qenë shumë të rëndësishme. Duke pasur parasysh kufizimet financiare dhe kapacitetet e kufizuara të institucioneve qeveritare që të zbatojnë të gjitha aktivitetet e planifikuara, Programi vlerësohet të jetë disi i gjerë dhe tepër optimist. Pavarësisht kuadrit të saj të gjerë, ekziston një marrëveshje e përgjithshme se PKBGJ ka mbuluar çështjet kryesore/fushat/sfidat që kanë qenë të ngutshme në vitin 2008, duke mbuluar: arsimin, shëndetësinë, gjendjen e tregut të punës, gjendjen socio-ekonomike të grave; pjesëmarrjen e grave në institucionet qendrore dhe lokale dhe në sektorin privat; dhe ajo gjithashtu ka shkaktuar një qëllim më të gjerë të përhapjes së vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e grave.

Programi gjithashtu nuk ka përfshirë nevojat e grave që u përkasin grupeve minoritare: lezbike, gej, biseksual dhe personave transeksualë (LGBT), sfidat me të cilat përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas (të tilla si martesat e hershme/fëmijëve), dhe nuk ka paraparë në mënyrë eksplicite aktivitete për të siguruar mbështetje dhe shërbime për të mbijetuarit nga dhuna seksuale gjatë luftës/konfliktit.

A kanë qenë aktivitetet dhe rezultatet në përputhshmëri me PKBGJ-në me misionin e gjithmbarshëm dhe me arritjen e objektivave të PKBGJ-së?

Në përgjithësi, objektivat e PKBGJ-së kanë qenë në përputhje me misionin e gjithmbarshëm të programit, edhe pse ka mundur të bëhet një përkufizim, koherencë dhe organizim më i mirë i objektivave të PKBGJ-së. Vërejtjet e përgjithshme që lidhen me objektivat janë si në vijim: 1) Objektivi 1: *Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e gruas* dhe Objektivi 7: *Përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport*, mund të bashkohen në një objektiv, ndërsa disa nën-objektiva dhe aktivitete shoqëruese të Objektivi 2 kanë mundur të përfshihen në objektivin e bashkuar; Objektivi 2 ka mundur të përfshihet në objektivin e bashkuar; 2) Objektivi 4 *Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave* dhe Objektivi 5 *Përmirësimi i treguesve të punësimit për gratë dhe vajzat* janë të ndërlidhur dhe të mbivendosur, dhe objektivat kanë mundur të bashkohen në një objektiv të vetëm; 3) Objektivat e PKBGJ-së nuk kanë qenë të kuantifikuara, përkatësisht nuk janë përcaktuar mbi bazën e rezultateve, por në të vërtetë kanë qenë deklarata që mëtojnë përmirësimin, rritjet dhe arritjet në fusha të ndryshme; 4) edhe nën-objektivat nuk janë specifike dhe të matshme: objektivi sasiore është përcaktuar për vetëm njërin prej 21 nën-objektivave të Programit.

Një vlerësim i detajuar i secilës prej fushave programatike të PKBGJ-së është elaboruar në seksionin në vijim:

Objektivi 1. Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin e gruas. Nën-objektivat dhe aktivitetet e parapara sipas këtij objektivi janë në përputhje me objektivin, por siç u përmend më lart, nën-objektivat dhe aktivitetet e përfshira në objektivat e tjera janë të rëndësishme për arritjen e këtij objektivi. Ky objektivi ka përfshirë një aktivitet të përkufizuar në mënyrë të paqartë për krijimin e mekanizmave për sigurimin dhe promovimin e transparencës, që nuk ka përmbajtur ndonjë shpjegim të veçantë lidhur me atë se çfarë fusha kanë qenë të nevojshme për të rritur transparencën. Në anën tjetër, kjo ka penguar vlerësimin nëse aktiviteti i planifikuar ka kontribuar në arritjen e objektivit të caktuar.

Objektivi 2. Rritja e qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësor: Ky objektivi përfshinë 4 nën-objektiva dhe vetëm njëri kontribuon në objektivin e caktuar, kurse tre të tjerët janë në përputhje me Objektivin 1, përkatësisht për promovimin e barazisë gjinore dhe trajtimit të çështjeve gjinore në sistemin arsimor.

Objektivi 3. Përmirësimi i shëndetit të vajzave dhe grave duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të tyre: Përderisa ky objektivi mëton përmirësimin e shëndetit vetëm të grave, dy nën-objektivat synojnë edhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për burrat, por pa aktivitete specifike për arritjen e nën-objektivave të përcaktuara. Ky objektivi përfshin aktivitete të lidhura me rregullimin e sigurimit shëndetësor, një objektivi që konsiderohet të jetë shumë optimist, dhe që pritet të prezantohet në Kosovë. Ky objektivi përfshin një aktivitet të përcaktuar për “rritjen e qasjes në institucionet shëndetësore», që në fakt është më tepër një objektivi se sa një aktivitet. Gjithashtu, është përfshirë një aktivitet për të siguruar transportin emergjent dhe angazhimin e komunitetit në transportimin e grave deri në spital, që nuk duket si një aktivitet i përshtatshëm, pasi qasja në transportin emergjent duhet të ofrohet për të gjithë ata që kanë nevojë. Ky objektivi synon për të siguruar pagesat e pushimit të lehonisë edhe për gratë e papuna, që duket tepër optimiste, duke pasur parasysh numrin e madh të grave të papuna si dhe burimet e kufizuara financiare qeveritare.

Objektivi 4. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave: Ky objektivi fokusohet në mbështetjen e krijimit dhe zhvillimit të bizneseve në pronësi të grave dhe kjo përfshin aktivitete të rëndësishme për arritjen e objektivit të caktuar, duke përfshirë sigurimin e kredisë, trajnimet, panairët, klubet e biznesit, etj.

Objektivi 5. Përmirësimi i treguesve të punës për gratë dhe vajzat: Në përgjithësi, ky objektivi përfshin aktivitete të përkatëse në përputhshmëri me objektivin e caktuar. Kjo përfshinë një aktivitet në lidhje me programin e ndihmës sociale, një aktivitet i ngjashëm është përfshirë nën Objektivin 6. Aktivitetet e parapara iu kanë përmbajtur vetëm ofrimit të pushimit të lehonisë, ndërsa shërbimet e tjera si kujdesi ndaj fëmijëve është gjetur se përbënë një ndryshim në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe dukshëm mungon.

Objektivi 6. Përmirësimi i gjendjes sociale të grave në rrezik përmes rritjes së qasjes në shërbime sociale cilësore: Nën-objektivat dhe aktivitetet janë në përputhje me objektivat e caktuara; aktivitetet në nën-objektivin 6 përfshijnë masat e asistencës sociale për të mbështetur gratë që vuajnë nga gjendja e rëndë ekonomike, zhvillimin e politikave dhe masave për të siguruar shërbime për gratë e mbijetuara të dhunës familjare dhe gratë e moshuara.

Objektivi 7. Përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport: Ky objektivi ka përfshirë vetëm aktivitetet në fushën e mediave, duke neglizhuar fushat e kulturës dhe sportit.

Objektivi 8. Të arrihet pjesëmarrje e barabartë e të dyja gjinive në vendimmarrje për të gjitha çështjet e rëndësishme në shoqëri: Ky objektivi ka paraparë aktivitetet e nevojshme për të arritur objektivin e synuar, edhe pse siç u përmend, ka mundur të bashkohet me Objektivin 1.

Si përmbledhje, PKBGJ-ja ka qenë një dokument i rëndësishëm, që përmban objektivat dhe aktivitetet kyçe për të arritur misionin e përgjithshëm të PKBGJ-së, edhe pse një organizim dhe harmonizim më i mirë i kornizës së projektimit ka mundur të jetë më i përshtatshëm.

3.1.1 Inputet gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, disa korniza të politikave publike, të tilla si legjislacioni dhe strategjitë kombëtare, janë miratuar duke plotësuar boshllëqet e kornizave të politikave të identifikuar në dokumentin e PKBGJ-së, dhe ka parashikuar të adresohet përmes aktiviteteve të ndryshme të përshkruara në dokument. Gjithashtu, janë paraqitur edhe mekanizma të ri, që të gjithë kanë kontribuar drejt progresit në arritjen e objektivave të përcaktuara të PKBGJ-së. Përveç kësaj, duhet të ofrohet një përshkrim i shkurtër i legjislacionit të ri, strategjive dhe mekanizmave.

Legjislacioni i ri

- Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, u zhvillua nga ABGJ si institucioni kryesor. Ligji është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në korrik të vitit 2010. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj përmes masave të përshtatshme ligjore ndaj pjesëtarëve të familjes që janë viktimat të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ky ligj përmban dispozita për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave;
- Janë miratuar dy Udhëzime Administrative (UA) të rëndësishme të cilat mbështesin zbatimin e Ligjit të Kosovës mbi Dhunën në Familje: UA nr 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryerësit të dhunës në familje dhe UA Nr. 02/2013 për mënyrën e trajtimit të kryerësve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor ndaj varësisë së alkoolit dhe substancave psikotropike;
- Nën udhëheqjen e ABGJ-së, në vitin 2013, qeveria e Kosovës ka hartuar dhe miratuar Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë;
- Në vitin 2012, Ligji i Kosovës për ndihmë juridike ka listuar viktimat e dhunës në familje, si një kategori me të drejtë që të aplikojnë për ndihmë juridike falas;
- Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, është shpallur në dhjetor të vitit 2011. Qëllimi i këtij ligji është “përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta”. Kategoritë që përfitojnë nga ky ligj janë “viktimat civile, invalidë civil të luftës dhe familjeve të personave të marr peng apo të zhdukur gjatë luftës”. Ligji nuk përmend në mënyrë specifike të mbijetuarit e dhunës seksuale apo të torturës gjatë luftës, si një kategori e veçantë e viktimave civile apo të burgosur të luftës;
- Ligji Nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë, i shpallur në janar të vitit 2009. Siç është përcaktuar me këtë ligj, çdo femër e moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç ka të drejtë që të kërkoj ndërprerjen elektive të shtatzënisë, ndërsa femrat e moshës gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare duhet të marrin pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor. Ndërprerja elektive e shtatzënisë mund të bëhet deri në fund të javës së dhjetë (10) të shtatzënisë. Neni 14 thotë qartë se ndërprerja e shtatzënisë me motiv të përzgjedhjes se gjinisë së frytit është e ndaluar.
- Ligji Nr. 03/L-212 i punës, i shpallur në nëntor të vitit 2010. Me këtë ligj është prezantuar formula e re e pushimit të lehonisë, ku në gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, pagesa do të bartet nga punëdhënësi me kompensim prej 70 për qind të pagës bazë; në tre muaj në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim prej pesëdhjetë për qind të pagës mesatare në Kosovë, dhe gruaja e punësuar ka të drejtë të vazhdojë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre muaj të tjerë pa pagesë. Ligji përcakton gjithashtu se në marrëveshje me nënës, e drejta e pushimit për tre muaj largohet dhe tre muaj pushim pa pagesë mund të barten tek babai i fëmijës;

- Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125 i shpallur në prill të vitit 2011. Ndër të tjera Ligji thekson se kujdesi shëndetësor do të zbatohet përmes sigurimit të kushteve të nevojshme për gratë shtatzëna dhe gratë pas lindjes, dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe të rinjve;
- Ligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i shpallur në gusht të vitit 2013. Sipas *nenit mbi parimet themelore për luftimin e trafikimit me njerëz*, ligji përcakton se në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore të gjitha aktivitetet kundër trafikimit duhet të marrin parasysh aspektin gjinor, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave viktime. Ligji gjithashtu thekson se gratë shtatzëna, të cilët janë viktime të trafikimit kanë të drejtë për strehim në një qendër mbrojtëse për një periudhë deri në një vit, me mundësi vazhdimi;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2013 përfshinë një veprim afirmativ sipas të cilës gratë fermer kanë të drejtë në pesë pikë shtesë në vlerësimin e aplikacionit të tyre për grante dhe subvencione.

Dokumentet kombëtare strategjike

- Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, i miratuar në gusht të vitit 2011. Kostoja totale e programit ka qenë 2.4 milionë euro, nga të cilat qeveria ka ndarë një buxhet prej 1.6 milionë eurove. Programi ka përcaktuar masat e ndara në tri shtylla dhe detajon aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës për të parandaluar dhe luftuar këtë dukuri, dhe njëkohësisht për rehabilitimin dhe integrimin e të mbijetuarve;
- Në vitin 2011, Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar Strategjinë për Shëndetin e Nënës, fëmijës, adoleshentit dhe shëndetin riprodhues 2011-2015. Strategjia përbëhej nga aktivitetet e organizuara në të gjithë nëntë fushat prioritare në vijim: amësia e sigurt; shëndeti i fëmijëve; shëndeti i adoleshentit; planifikimit familjar; kanceri i traktatit riprodhues; infeksionet seksualisht të transmetueshme; infertiliteti; barazia gjinore dhe dhuna në familje;
- Mbështetur nga UN Women, ABGJ ka zhvilluar planin e veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria" 2013-2015 e cila u aprovua në janar të vitit 2014. Ky Plan Kombëtar përbëhet nga tri objektiva: 1) Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe në ruajtjen e paqes dhe mbrojtje; 2) një perspektivë e integruar gjinore dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në strukturat e sigurisë dhe 3) Viktimat e dhunës seksuale dhe forma të tjera të dhunës që kanë të bëjnë me konfliktin/luftën për të pasur qasje në mekanizmat funksional për mbrojtjen, qasjen në drejtësi, si dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre;
- Komiteti i Kosovës për HIV/AIDS ka zhvilluar Planin Strategjik të Kosovës për HIV/AIDS 2009 - 2013. Plani parasheh që programet dhe shërbimet për parandalim, trajtim dhe kujdes duhet të dizajnohen në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë nevojat specifike të grave dhe burrave. Plani parashikon gjithashtu masat për parandalimin e bartjes së HIV/AIDS nga nëna tek fëmija;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011, përshkruan që gratë në Kosovë mbeten në një pozitë të pafavorshme sa i përket punësimit, varfërisë, arsimimit, mundësisë për të zgjedhur pozita vendimmarrëse, pozita e grave në zonat rurale dhe urbane të tilla si analfabetizmi, qasje në kujdesin cilësor shëndetësor të grave gjatë dhe pas shtatzënisë. Strategjia gjithashtu vë në dukje mungesën e analizave dhe planifikimit të buxhetit nga perspektiva gjinore në nivel qendror dhe lokal;
- Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit (2011-2013) i aprovuar në vitin 2008. Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2014 përfshin vetëm një objektiv në lidhje me gratë: të rritet ndërgjegjësimi i publikut mbi fenomenin e trafikimit me qenie njerëzore të grupeve më të rrezikuara (p.sh. fëmijët, të rinjtë dhe gratë) në lidhje me çështjet e trafikimit. Megjithatë, Raporti i monitorimit dhe vlerësimit të kësaj Strategjie i kryer në vitin 2014, nuk e ka vlerësuar këtë objektiv specifik, në lidhje me gratë;
- Plani për fuqizimin ekonomik të grave për 2011-2013 që kishte objektivat e mëposhtme: a) përshpejtimi i zbatimit të përparimit të zhvillimit gjinor dhe politikave të grave, b) përshpejtimi i zbatimit të angazhimeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për barazinë

gjinore dhe fuqizimin e grave, c) integrimin e çështjeve gjinore në politikat makro dhe ato në nivel sektori, d) lidhja me partnerë bashkëpunues dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe e) zgjerimi i koordinimit, monitorimit dhe llogaridhënies, si dhe vlerësimi dhe hulumtimi. Megjithatë, bazuar në informacionet e grumbulluara gjatë këtij vlerësimi mund të vërehet se për shkak të financimit të pamjaftueshëm, nuk është zbatuar plani.

Mekanizmat e sapo prezantuar

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar propozimin ABGJ për emërimin e një *Koordinatori Kombëtar* dhe themelimin e një Grupi Koordinues për monitorimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje 2011-2014. Sekretariati Koordinues është një organ përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të përcaktuara në Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit. Grupi Koordinues i ABGJ-së përbëhet nga Kryeshefi i ABGJ-së, zëvendës ministrat e ministrive të linjës dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës është themeluar në nëntor të vitit 2013. Qëllimi i shoqatës është rritja e përfaqësimit të grave police në pozita vendim-marrëse, adresimi i sfidave dhe shqetësimeve të grave që shërbejnë në forcat e policisë; promovimi i barazisë gjinore në Policinë e Kosovës për të mbështetur zhvillimin profesional të grave dhe promovuar shoqatën dhe gratë police të Kosovës ndërkombëtarisht (UN Women, 2015). Themelimi i Shoqatës është parë si një zhvillim pozitiv në raportin e Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2013 (Komisioni Evropian 2013).

Me mbështetjen e UN Women, në vitin 2012, në Gjakovë, Gjiilan dhe Dragash, janë themeluar *Mekanizmat për Koordinim Komunal*, që përbëhen nga përfaqësues të Policisë së Kosovës, gjyqësori, OJQ-të, strehimoret dhe institucione të tjera që punojnë me të mbijetuarit e dhunës në familje. Këto mekanizma kanë për qëllim të përmirësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin në mes të të gjitha institucioneve të përfshira në parandalimin e dhunës në familje dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar edhe planet lokale të veprimit për mbrojtje kundër dhunës në familje.

Gjatë zbatimit të PKBGJ, Agjencia për Barazi Gjinore mori hapat e parë në drejtim të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ). Në vitin 2012, rreth 150 pjesëmarrës morën pjesë në konferencën ndërkombëtare për “Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor: Praktikë dhe Sfidat” e organizuar nga ABGJ në bashkëpunim me LOGOS, DEMI/USAID, GIZ dhe SIDA. Qëllimi i konferencës ishte diskutimi i praktikave më të mira në zbatimin e BPGJ në nivel qendror dhe lokal. Në të njëjtin vit, RrGGK ndërmori aktivitetin e parë kërkimor të BPGJ të quajtur “**Me çfarë kosto?**” mbi koston e financimit të mbështetjes për të mbijetuarit e dhunës në familje. Që nga viti 2014, Komuna e Kamenicës ka përfshirë rregullisht BPGJ-në në dokumentet e saj të planifikimit buxhetor. Ata kanë përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë, gjuhës e ndjeshme gjinore, si dhe planifikimin e ardhshëm të BPGJ. Komuna e Gjakovës dhe Hanit të Elezit gjithashtu kanë përfshirë elemente të rëndësishme të BPGJ-së në dokumentet e tyre. Në vitin 2012, UN Women ka organizuar trajnime mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor për anëtarët e mekanizmave të koordinimit të Dragashit, Gjakovës dhe Gjiilanit. Në të njëjtin vit me mbështetje nga LOGOS, komuna e Vitisë ka zbatuar projektin “Barazia Gjinore dhe Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor”. Komponenti i parë i projektit përbëhej nga aktivitetet e trajnimit të cilat përfshinin: tri trajnime me zyrtarë nga stafi i komunës, një trajnim me përfaqësues të sektorit të arsimit dhe të shëndetësisë, dhe një trajnim me anëtarët e Kuvendit komunal. Tema e këtyre trajnimeve ishte “Përgjegjësia e institucioneve në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore” në të gjitha fushat e jetës dhe të punës. Komponenti i dytë i projektit përbëhej nga sondazhi me qytetarët e komunës së Vitisë për buxhetimin gjinor, tri trajnime për zyrtarët komunal, raporti me shkrim i bazuar në gjetjet nga anketa dhe rezultatet u shpërndanë dhe u diskutuan në tryezën e rrumbullakët.

Me mbështetjen e RrGGK, në vitin 2012 janë themeluar tetë Grupe për Avokim për Barazi Gjinore (GABGJ) në këto komuna: Novobërdë, Dragash, Shtime, Gjiilan, Prizren, Mitrovicë, Mamushë dhe Gjakovë, dhe në vitin 2013 u krijuan edhe dy të tjera, përkatësisht në Podujevë dhe Gllogoc. Këto

grupe bashkojnë gratë në politikë dhe gratë në shoqërinë civile në përpjekje për të avokuar mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në nivel komunal. RrGGK u ka ofruar mentorim dhe mbështetje të vazhdueshme këtyre grupeve.

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ, janë organizuar rregullisht fushata sensibilizuese, nga ABGJ, ZBGJ dhe OSHC lokale. Ato përfshijnë:

- 16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës në Familje, që mbahet çdo vit nga 25 nëntori deri më 16 dhjetor, (që nga vitit 2009, ky është një aktivitet i rregullt në kalendarin e aktiviteteve të të gjitha institucioneve të Kosovës),
- Dita e grave organizuar më 8 mars,
- Që nga viti 2010, ABGJ e mbështet panairin “Gratë në biznes” të organizuar nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Investimeve në Kosovë (KIESA). Në këtë eveniment, shpërndahen certifikata për biznese të suksesshme,
- Në disa komuna organizohet Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale,
- Çdo tetor në Kosovë shënohet Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e gjirit ,
- Java Evropiane për testim për HIV / AIDS,
- Aktivitete ndërgjegjëse mbi të drejtat e pronësore dhe trashëgimisë,
- Trajnime për Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ të mbështetur nga UN Women, Kosova është bërë një anëtare aktive e Lobit Rajonal të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore, i cili bashkon gratë politike dhe aktiviste nga rajoni të cilat janë angazhuar për qëllimet e thellimit të sigurisë njerëzore, promovimin e të drejtave të grave dhe pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes dhe për të thyer barrierat e politikës etno-centrike,
- Në vitin 2009, ABGJ ka organizuar një Konferencë Ndërkombëtare me temën “Gratë dhe identiteti”, e cila u fokusua në identitetin gjinor dhe perspektivën ndërdisiplinore, politikat gjinore, luftën dhe drejtësinë.

3.2 Efektiviteti i PKBGJ

Ky seksion vlerëson shkallën në të cilën janë arritur dhe zbatuar objektivat e përcaktuara dhe aktivitetet e parapara në kuadër të PKBGJ.

3.2.1 Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Me qëllim të përmirësimit të statusit socio-ekonomik të grave në PKBGJ, janë organizuar aktivitete në të tri objektivat strategjike të mëposhtme: *fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave, përmirësimi i treguesve të punësimit për gratë dhe vajzat, si dhe përmirësimi e situatës sociale të grave në rrezik përmes ofrimit të shërbimeve sociale cilësore*. Objektivi i fundit përmban edhe aktivitetet që lidhen me dhunën në familje, të cilat janë vlerësuar në seksionin 3.2.3 të këtij raporti.

Vlerësimi i progresit të arritur në drejtim të përmbushjes së këtyre tri objektiveve është realizuar duke përdorur të dhëna sekondare. Në vitin 2013, 18.4 për qind e grave kryefamiljare jetonin në varfëri dhe 18.2 për qind e grave në Kosovë jetonin në rrethana të tilla. Në krahasim me treguesit bazë, situata është përmirësuar, por objektivi i synuar nuk është arritur, edhe pse ishte shumë ambicioz duke pasur parasysh gjendjen ekonomike në Kosovë. Raportet e rregullta të ASK-së për mirëqenien sociale nuk e bëjnë dallim mes familjeve përfituese të asistencës sociale për kokë banori sipas gjinisë, edhe pse ky informacion është në dispozicion në bazën e të dhënave të MPMS-së. Siç është raportuar në Buletinin e ABGJ 2013, në vitin 2013 Ministria për Komunitete dhe Kthim ka mbështetur ndërtimin e 72 shtëpive, nga të cilat 15 përfitues ishin gra kryefamiljare. Në bazë të dhënave të ofruara për këtë vlerësim, strehimi social u është dhënë grave kryefamiljare në komunën e Mitrovicës, Suharekës (17 ekonomive familjare me gratë kryefamiljare), Viti (është siguruar strehim social për 6) dhe Malisheva (nuk ka të dhëna për numrin e rasteve).

Qendrat për Shërbime Sociale që veprojnë në secilën komunë ofrojnë një gamë të gjerë të shërbimeve

të cilat gjithashtu përfshijnë shërbime të këshillimit të familjes; Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve; strehim për personat e moshuar dhe ata me nevoja të veçanta; shërbimet për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe personat e trafikuar, etj. Aktivitetet e planifikuara të PKBGJ për të ndihmuar gratë e varfra përmes skemës së shërbimeve sociale nuk kanë dëshmuar të kenë shërbime të veçanta të dizajnuara në mënyrë specifike për të shënjestruar gratë e varfra. Gjatë intervistave dhe diskutimeve të fokus grupeve, është raportuar se MKRS dhe komunat herë pas here kanë mbështetur një numër të grave të varfra duke i mbuluar shpenzimet që ndërlidhen me kujdesin shëndetësor, sigurimin e strehimit dhe ofrimin e mbështetjes financiare (për shembull, duke mbuluar shpenzimet për ngrohje gjatë dimrit). Përveç shërbimeve të strehimit për të moshuarit të ofruara nga MPMS-ja, nuk janë zhvilluar masa të tjera për të mbështetur këtë grup të grave, edhe pse ishte parashikuar në dokumentin PKBGJ.

Të dhënat e paraqitura në Shtojcën 1, tregojnë se pjesa e grave sipërmarrëse është rritur në vitin 2013, edhe pse ato janë kryesisht të përmasave të vogla sipërmarrëse. Për të mbështetur gratë në biznes, MTI ka organizuar disa aktivitete të cilat përfshijnë: panairë, trajnime dhe dhënie të granteve, konferenca, dhënie të çmimeve për gratë e suksesshme në biznes të përfshira në tregti dhe shërbime të sektorëve të prodhimit. Agjencia e NVM-ve e MTI-së, çdo vit organizon panairin 'Gratë në Biznes' me të cilin synon të promovojë dhe të rris sipërmarrjen në mesin e grave. Në vitin 2010, janë ndarë 25.000 Euro si subvencione për gratë në biznes. Në vitin 2012, me mbështetjen e MTI-së, është themeluar Oda Ekonomike e Grave me qëllim të mbështetjes, promovimit dhe zhvillimit të rolit të gruas në ndërmarrësi. Në vitin 2009, MTI-ja ka angazhuar 200 student në projektin e internshipi, nga të cilët gati se gjysma ishin femra. Duhet të theksohet se gjatë këtij vlerësimi nuk janë vënë në dispozicion të dhëna të sakta për buxhetin e përgjithshëm të ndarë për gratë sipërmarrëse dhe për numrin e grave përfituese nga grantet dhe mbështetja tjetër e ofruar nga MTI-ja.

Politikat e MBPZHR gjatë viteve të PKBGJ, kanë kontribuar në angazhimin e grave në sektorin e bujqësisë përmes trajnimeve, shërbimeve këshilluese, granteve dhe subvencioneve. Është e rëndësishme të theksohet se raporti i rregullt vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë nuk jep të dhëna të granteve dhe subvencioneve të përfituesve të zëbërthyer sipas gjinisë. Meqenëse janë **kërkuar për këtë vlerësim, gjatë zbatimit të PKBGJ janë ofruar të dhëna për gjininë e marrësit të grantit. Duke iu referuar raportit të dhënë nga ZBGJ të Ministrisë, ka prova se përqindja e femrave që përfitojnë nga grantet dhe subvencionet ka shënuar rritje, ndonëse mbetet dukshëm më e ulët se ajo e meshkujve. Për shembull, në vitin 2010 dhe 2011 vetëm katër për qind e granteve dhe subvencioneve janë ndarë për gratë, e që në vitin 2012 u rrit në 13.5 për qind. Në vitin 2012, janë ndarë në total 45.000 Euro për gratë e angazhuara në rritjen dhe kultivimin e dhive, deleve, lopëve, bletëve dhe drithërave (Gazeta ABGJ, 2013). Gjithashtu, 140 gra janë informuar për shërbimet dhe mbështetjen financiare në dispozicion nga MBPZHR-ja.**

Gjatë periudhës 2009-2014, ABGJ ka ndarë rreth 120.000 euro, për 44 përfitues, duke përfshirë OSHC të grave si dhe për gratë sipërmarrëse. Për të mbështetur gratë në biznes, Ministria e Infrastrukturës, në vitin 2009 ka ndërtuar 220 metra rrugë në fshatin Krushë e Madhe, e cila çon në fabrikën "Gratë Fermere", në vlerë prej 45.000 euro dhe është mbështetur veprimtaria e biznesit të kësaj fabrike të drejtuar nga gratë. Këta shembuj konfirmojnë edhe një herë se të gjitha ministrat mund të kontribuojnë në përmirësimin e jetesës dhe kushteve të grave duke punuar, duke marrë masa të përshtatshme brenda sektorit dhe mandatit të tyre.

Gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ, Komuna e Mitrovicës, Obiliqit, Lipjanit, Prizrenit, Vitisë, Malishevës, dhe Prishtinës kanë ofruar trajnime, grante dhe subvencione, kanë organizuar panairë dhe aktivitete të tjera për të mbështetur angazhimin e grave në biznese të vogla dhe gjithashtu për të mbështetur rritjen e bizneseve në pronësi të grave. Për shembull, në vitin 2008, me mbështetjen e MPMS dhe "DVV International", komuna e Suharekës ka organizuar kurse trajnimi për kompjuter për 111 vajza; Komuna e Vitisë ka ofruar mbështetje financiare për dy shoqata të grave me nga 2,000 euro për secilën dhe ka mbështetur një biznes në pronësi të grave me një subvencion prej 2,000 euro; Komuna e Fushë-Kosovës ka organizuar trajnimin e 120 grave dhe vajzave.

Gjithashtu, OSHC lokale kanë qenë shumë aktive në sigurimin e granteve dhe aktiviteteve mbështetëse arsimore për grupet e marginalizuara të grave, duke synuar zbutjen e varfërisë dhe rritjen e mundësive të tyre për punësimi dhe të ardhura. Në vitin 2012, në konsultim të ngushtë me 100 anëtarët e ndryshëm të saj, RrGGK vendosi të krijojë *Fondin e Grave të Kosovës. Fondi, i mbështetur bujarisht nga Kvinna till Kvinna nga Suedia, ka ofruar grante të vogla për aplikantët individualë (deri në 1,000 €) dhe për 12 organizatat e grave (në vlerë prej 10,000 euro) të cilave u mungonte qasja në burime të tjera të financimit dhe kërkonin më shumë të drejta për gratë, veçanërisht mes grupeve rurale dhe/ose të marginalizuara. Gjithashtu, RrGGK ka përdorur këtë program grantesh për mentorimin e anëtarëve të saj në procesin e shkrimit të granteve, duke përmirësuar edhe më tej kapacitetet e tyre për të aplikuar për fonde nga donatorët e tjerë. Në vitin 2013, RrGGK ka lansuar tri raunde të granteve, si dhe ka rritur shumat e granteve nga një maksimum prej 3000 euro. Nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës, 22 organizata kanë pasur mundësi të zbatojnë idetë e tyre dhe të arrijnë përfitues të ndryshëm, me një buxhet të përgjithshëm prej 66,209 euro. Nismat kanë prekur disa nga grupet më të rrezikuara në Kosovë, veçanërisht ato që jetojnë në zonat rurale dhe minoriteteve, disa nga të cilët kanë marrë pjesë në aktivitete të tilla për herë të parë. OShC-të lokale, të tilla si RrGGK, në vitin 2011 kanë trajnuar dhe mentoruar 40 gra për bletari.*

Për më tepër, "Women for Women International" ka ofruar edukim për të drejtat dhe shkathtësitë jetësore mbështetjen e të ardhurave, shëndetin dhe mirëqenien, vendimmarrjen në familje dhe komunitet, rrjetet sociale dhe rrjetet e sigurta) dhe trajnime profesionale (trajnime profesionale dhe të biznesit). Gjatë vitit 2009-2012, rreth 6,500 gra nga 12 komuna kanë marrë pjesë në trajnime ekonomike dhe sociale. Sa i përket trajnimit profesional, kursi që është ndjekur më së shumti është ai i hortikulturës, i ndjekur nga ofrimi i shërbimeve dhe artizanateve por ka pasur edhe disa në bletari dhe prodhimet e qumështit. Sipas vendndodhjes, 52 përqind e grave të trajnuara ishin nga zonat rurale dhe 48 përqind nga zonat urbane.

Edhe pse ligjërisht pasuria e krijuar gjatë martesës duhet të regjistrohet në emër të të dy bashkëshortëve, gratë nuk përfitojnë nga kjo e drejtë kryesisht për shkak të normave mbizotëruese **të kulturore ose mungesës** së ndërgjegjësimit. Duke pasur parasysh se shumica e grave nuk janë pronar të ligjshëm të pronës, qasja në kredi për biznese fillestare dhe/ose zhvillimin e biznesit është shumë e kufizuar sipas Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2013, vetëm pesë për qind e shtëpive janë në pronësi të grave, duke treguar një rënie me dy pikë përqindje nga viti 2009. Megjithatë, sipas Agjencisë së Kadastrave të Kosovës, në vitin 2013, rreth 16 përqind të pronave janë në pronësi ose në pronësi bashkë të grave. Për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e grave për pronën, në baza vjetore, ABGJ, ZBGJ dhe OSHC lokale organizojnë fushata ndërgjegjëse për të drejtat e grave për pronën.

Me gjithë progresin e shënuar deri në fund të vitit 2013, sipas të dhënave, dallime të mëdha mbizotërojnë në tregun e punës (ASK, 2014).

- Përafërsisht vetëm një në pesë (21.1%) femra në moshë pune ishin aktive në tregun e punës, në krahasim me tre të pestat e popullsisë së meshkujve në moshë pune (61.2%);
- Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune ishte vetëm 12.9%, në krahasim me 40.0% për meshkujt;
- Gati 80 përqind e grave e kishin statusin e të punësuarit (në krahasim me 77% të meshkujve) dhe vetëm 13 përqind e grave ishin të vetë-punësuar, krahasuar me 25 për qind të meshkujve;
- Segregimi profesional mbetet i lartë në mesin e femrave, pasi që 40 përqind ishin të punësuar në të ashtuquajturat punë tradicionale për femra p.sh arsim dhe shëndetësi;
- Mospërputhja e pagave ka mbetur e pandryshuar por e parëndësishme, me një tendencë të vogël ku meshkujt marrin paga më të larta se femrat.

Për qëllim të këtij vlerësimi, mund të raportohet se të gjitha institucionet, ato të qeverisë qendrore dhe lokale, donatorët dhe OSHC lokale kanë bërë intervenime për të krijuar vende të punës dhe rritur qasjen e grave në tregun e punës dhe zbutjen e varfërisë në mesin e tyre. Kontribuuesit kryesorë qeveritarë në zbutjen e papunësisë gjatë PKBGJ, kanë qenë të MPMS përmes implementimit të politikave aktive të tregut

të punës, MTI përmes ofrimit të ndërmarrësisë ka mbështetur programet dhe zbatimin e ndërhyrjeve mbështetëse për ndërmarrjet ekzistuese (grante, voucher skemat, praktika), dhe MBPZHR përmes sigurimit të subvencioneve, granteve dhe trajnimeve për zhvillimin e bujqësisë. Gjatë implementimit të PKBGJ gjithashtu janë zhvilluar aktivitete për ndërgjegjësimin e grave në lidhje me qasjen dhe të drejtat pronësore. Ekzistojnë të dhëna se përqindja e grave sipërmarrëse dhe punësimi ka vazhduar të rritet gjatë PKBGJ-së. Megjithatë, progresi i arritur nuk ka bërë ndonjë ndryshim të madh në gjendjen ekonomike të grave dhe nuk ka përmirësuar statusin e tyre ekonomik. Politikat e ndryshme dhe veprimet që priten të ndërmerren në kuadër të kornizës së PKBGJ, mes tjerash edhe *Plani i Veprimit të Kosovës për Fuqizim Ekonomik*, një kornizë e punësimit dhe politikave të fuqizimit pro-gjinor për fat të keq nuk ka hyrë në fuqi ashtu siç ishte parashikuar, ndërsa politikat sektoriale kanë mbetur kryesisht të shkëputura nga njëra-tjetra dhe nuk krijojnë sinergji nevojshme.

3.2.2 Shëndetësia

Për përmirësimin e shëndetit të grave dhe vajzave, aktivitetet e planifikuara janë organizuar në tri nën-objektiva, siç janë: 1) siguri se politikat dhe programet shëndetësore i përgjigjen dallimeve dhe nevojave specifike shëndetësore gjinore; 2) rritja e njohurive dhe të kuptuarit të grave dhe burrave për shëndetin dhe nevojat e tyre; si dhe 3) mbështetja dhe garantimi i qasjes së plotë dhe të barabartë në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

Duke pasur parasysh se asnjë përgjigje nuk është dhënë nga ZBGJ-të në Ministrinë e Shëndetësisë dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, vlerësimi i arritjes së objektivave të përcaktuara në këtë fushë bazohet në hulumtimin në zyrë, informatave nga ABGJ, ZBGJ, UNFPA dhe diskutimet e fokus grupeve. Me qëllim që të sigurohet se politikat dhe programet shëndetësore i përgjigjen dallimeve dhe nevojave specifike shëndetësore gjinore (nën-objekti 1), tre nga gjashtë aktivitetet e parapara nuk janë mbajtur pasi që ndërlidheshin me zbatimin e sigurimit shëndetësor, i cili akoma nuk aplikohet në Kosovë. Këto aktivitete ndërlidheshin me përcaktimin e sigurimit shëndetësor për të gjitha hallkat e zinxhirit të shërbimeve shëndetësore për burrat dhe gratë, duke filluar nga përfshirja në paketën bazë të sigurimit shëndetësor të grupeve të diagnozave që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me shëndetin riprodhues të grave dhe vajzave e deri tek përfshirja e trajtimit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS brenda skemës së sigurimeve shëndetësore.

Edhe pse skema e sigurimeve shëndetësore nuk u prezantua gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ-së, megjithatë u ofruan medikamente falas për HIV/AIDS. Aktiviteti i parashikuar për legjitimimin e të drejtës së kompensimit financiar të maternitetit për gratë e papuna nuk u zbatua, por siç prezantohet në këtë raport pushimi i lehonisë për nënat e punësuar është zgjatur deri në 12 muaj, nga të cilat nëntë muaj paguhen dhe ekziston e drejta e përdorimit të muajve pa kompensim. Plani për të harmonizuar veprimet ndër-sektoriale ligjore që kanë të bëjnë me pushim të lehonisë dhe çështje të ngjashme nuk është zbatuar, edhe pse gjatë intervistave me akterë të ndryshëm ka mbetur e paqartë se çfarë pritej të arrihet me zbatimin e këtij aktiviteti. Gjithashtu, gjatë ciklit jetësor të PKBGJ-së, plani për ofrim pa pagesë të vaksinimit për HPV nuk ka ndodhur asnjëherë.

Sa i përket kryerjes së aktiviteteve të parapara në rritjen e njohurive dhe të kuptuarit të shëndetit të grave dhe burrave si dhe nevojat e tyre, mund të raportohet si në vijim:

- a) fushatat vetë-dijësuese mbi dhunën në familje, që trajtojnë ndikimin e dhunës në shëndet, janë realizuar rregullisht gjatë gjithë periudhës së zbatimit të PKBGJ,
- b) aktiviteti i mbledhjes dhe raportimit vjetor të të dhënave të ndërlidhura me shëndetin (të ndara sipas gjinisë)⁴,
- c) U zhvillua Strategjia për Shëndetin e Nënës, fëmijëve, të rinjve si dhe shëndeti riprodhues 2011-2015, ndërsa shkalla e zbatimit mbetet e pa vlerësuar,

⁴ Informacioni i vetëm lidhur me shëndetësinë ka të bëjë me normat e vdekjes dhe shkakun e vdekjes, ndarë sipas gjinisë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Ministrinë e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës për të mbledhur dhe raportuar këto të dhëna, por faqja e tyre nuk është e përditësuar dhe nuk përmban raporte: Raportet Perinatale edhe pse të përgatitura çdo vit nuk janë në dispozicion online.

- d) ABGJ, ZBGJ komunale, UNFPA, Shoqata për Edukim dhe Përkujdesje Familjare dhe organizata të tjera kanë organizuar disa fushata ndërgjegjësimi për planifikimin familjar. UNFPA ka organizuar trajnime për mjekët dhe të rinjtë në fushën e planifikimit familjar. Programi i Përbashkët i UNFPA dhe UNICEF siguroi ngritjen e kapaciteteve, ndihmë teknike dhe aktivitete avokimi me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve të kujdesit ndaj nënës, fëmijës dhe shëndetit riprodhues në nivel të kujdesit tretësorë, dytësorë dhe parësor shëndetësor.
- e) Në lidhje me planin për të zhvilluar udhëzime edukative të shkollave mbi planifikimin familjar për djemtë dhe vajzat, përfaqësuesi i UNFPA vuri në dukje se edhe pse tekstet shkollore përmbajnë informata lidhur me planifikimin familjar, ka indikacione se mësimdhënia dhe shkëmbimi i informatave nuk ka qenë në një nivel të duhur,
- f) Nuk ka asnjë informatë në dispozicion nëse shkollat kanë zhvilluar udhëzime edukative programore mbi ushqimin (nutricitetin) dhe higjienën.

Më poshtë janë të paraqitura aktivitetet që ishin në plan për tu realizuar në dokumentin e PKBGJ-së, por që kurrë nuk ndodhi një gjë e tillë:

- a) plani për të mbledhur të dhëna të ndara gjinore në përdorimin e serive të shëndetit publik dhe privat nuk është realizuar në vitin 2013,
- b) asnjë veprim nuk është ndërmarrë në drejtim të sigurimit të transportit efikas të grave në spitale në bazë të orientimit gjinor,
- c) nuk janë zbatuar programe për ekzaminimin e kancerit cervical gjatë periudhës 2008-2013, dhe
- d) nuk është zbatuar përfshirja e perspektivës gjinore në plane dhe programe mësimore të kurseve të Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Prishtinës.

Në vitin 2013, në bashkëpunim me UNFPA, Ministria e Shëndetësisë zhvilloi Udhëzuesin për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, udhëzues ky që është nënshkruar nga Ministri i Shëndetësisë (MSH). Gjithashtu edhe UNDP ofroi gjashtë trajnime për profesionistët mjekësor në identifikimin e rasteve të dhunës në familje në mbarë Kosovën, ku morën pjesë 180 punonjës të shëndetësisë. Në përputhje me aktivitetin e fundit në bazë të nën-objektivit 2, ZBGJ-të komunale në bashkëpunim me ZBGJ-të në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës organizuan vizita të rregullta vjetore të grave për ultrazë dhe mamografi. Për më tepër, janë organizuar fushata për ndërgjegjësim dhe ekzaminimin e mamografisë, kancerit të gjirit, kancerit cervical dhe infeksioneve nga ZBGJ në ministritë e linjës dhe komunat e Kosovës. Muaji i ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit shënohet në Kosovë çdo tetor, gjë që kontribuon në ngritjen e vetëdijes në mesin e grave për zbulimin e hershëm, trajtimin dhe përkujdesjen e veçantë që kërkohet nga kjo sëmundje. Në bazë të dhënave të ofruara për këtë vlerësim mund të raportohet se çdo vit, Komuna e Mitrovicës, Suharekës, Obiliqit, Lipjanit, Prishtinës, Vitisë, Malishevës, Kaçanikut, Dragashit dhe Gjakovës kanë organizuar fushata ndërgjegjëse në fushën e shëndetësisë si dhe kanë bërë edhe kontrolle shëndetësore gjinekologjike për gratë rome, ashkali dhe egjiptase.

Qendra për Luftimin e Kancerit të Gjirit (JETA/VITA) e themeluar në vitin 2006, ka qenë shumë aktive në ndërgjegjësimin e popullsisë dhe grave në lidhje me kancerin e gjirit. Për të rritur vetëdijësimin për rëndësinë e zbulimit të hershëm, JETA/VITA ka organizuar disa fushata ndërgjegjëse, takime dhe punëtori me vajza dhe gra, si dhe ka organizuar konferenca, fushata mediatike dhe ka shpërndarë broshura. Ministria e Shëndetësisë, UNFPA dhe akterë të tjerë kanë organizuar disa fushata ndërgjegjësimi për HIV/AIDS gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së. Megjithatë, numri i grave dhe burrave që dinë se ku të testohen për HIV mbetet shumë i ulët. Sipas studimit të MICS të vitit 2013 vetëm 15.5 % e femrave dhe 31 % e meshkujve të moshës 15-49 vjeç kanë njohuri për klinikat shëndetësore ku bëhen testet për HIV (UNFPA, 2014).

3.2.3 Dhuna në familje

Dokumenti i PKBGJ trajton dhunën në familje kryesisht nën-objektivin strategjik 6.2, që kërkon ngritjen e shërbimeve komunitare për gratë që përjetojnë probleme sociale. Një seri aktivitetesh janë

paraqitur në dokument për përmbushjen e këtij nën-objektivi, si p.sh:

- fuqizimi i strukturave institucionale për të ofruar shërbime për viktimat e trafikimit dhe dhunës,
- Trajnimi i personelit të gjykatave, Policisë së Kosovës dhe institucioneve qendrore vendore për trajtimin e viktimave të dhunës dhe trafikimit,
- riintegrimi i viktimave në shoqëri, dhe
- zhvillimi i një strategjie kombëtare për dhunën në familje.

Siç është paraqitur në Seksionin 3.1.1, në vitin 2011 Qeveria e Kosovës ka hartuar dhe aprovuar *Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit 2011-2014*. Me realizimin e këtij programi, në vitin 2015 është bërë edhe një vlerësim. Gjetjet nga Raporti i Vlerësimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014 do të përdoren për të vlerësuar efektivitetin e aktiviteteve të planifikuara të PKBGJ-së në lidhje me shkallën e zbatimit të aktiviteteve me qëllim të trajtimit dhe luftimit të dhunës në familje në Kosovë.

Në përputhje me veprimtarinë e parashikuar për zhvillimin e një strategjie kombëtare mbi dhunën në familje, në vitin 2010, ABGJ-ja ka filluar procesin e hartimit të programit të parë kombëtar për dhunën në familje, me mbështetjen e Iniciativës për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas në kuadër të UNDP-së dhe me një pjesëmarrje të gjerë të institucioneve shtetërore të Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare dhe organizatave lokale të shoqërisë civile. Programi i Kosovës 2011-2014 kundër Dhunës në Familje u aprovua në vitin 2011.

Raporti i Vlerësimit të Programit Kombëtar mbi Dhunën në Familje 2011-2014, vë në dukje se është përmirësuar infrastruktura shtetërore e Kosovës e krijuar për të ndihmuar dhe mbrojtur gratë dhe fëmijët si viktimat dhe mbijetues të dhunës në familje. Procesi ekstensiv i licencimit të punonjësve social dhe zhvillimit të standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve sociale është realizuar dhe vendosur gjatë zbatimit të programit kombëtar. Në përputhje me kërkesat e shtetit të Kosovës është finalizuar licencimi i shërbimeve kundër dhunës në familje të ofruara nga OJQ-ja, të cilat kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të ofruesve të shërbimeve. Sipas Kodit të ri Penal të Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale, avokatët e viktimës janë transferuar në Zyrën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës, të cilët janë paraparë që në gjykatë të veprojnë si përfaqësues të autorizuar të viktimave të dhunës në familje. Kjo ka rritur nivelin e qasjes së viktimave/të mbijetuarve në mjetet juridike edhe pse nuk ka vlerësim për cilësinë e shërbimeve të cilat u janë ofruar. Pavarësisht mbështetjes së vazhdueshme financiare për strehimoret që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, ata vazhdojnë të marrin një mbulim të pamjaftueshëm të shpenzimeve nga Ministria dhe komunat.

Pas finalizimit dhe miratimit të Programit për dhunën në familje, Drejtori Ekzekutiv i ABGJ-së u propozua me Dekret të Qeverisë, si zëvendës koordinator i Sekretariatit për Zbatimin e Programit të Dhunës në Familje. Siç u theksua në Seksionin 3.1.1, nën udhëheqjen e ABGJ-së, në vitin 2013, qeveria e Kosovës ka hartuar dhe miratuar *Procedurat Standarde të Operimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë*. Ky dokument ofron një përshkrim të detajuar mbi rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në mbrojtjen dhe ndihmën e të mbijetuarve të dhunës në familje, të tilla si: policia, punëtorët social, avokatët e viktimës, gjykatësit, mësuesit, ofruesit e kujdesit shëndetësor, prokurorët dhe stafi i strehimit në identifikimin referimin si dhe ndihmën për viktimat e dhunës në familje.

Me qëllim të rritjes së zbatimit të Ligjit të Kosovës për dhunën në familje, në vitin 2014, ABGJ-ja me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, hartoi komentarin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Komentari është zhvilluar për personelin gjyqësor, duke përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët. Me qëllim të përmirësimit të kuptuarit dhe zbatimit të kornizës ligjore përkatëse për dhunën në familje, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, nën drejtimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV), hartuan formë të kërkesës për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Format e kërkesës detajojnë informatat që do të ofrohen për aplikantin, masat që duhen kërkuar dhe rrethanat

që janë të rëndësishme për të nxjerrë një urdhër për mbrojtje.

Për të përmirësuar më tej nivelin e njohurive mbi legjislacionin kundër dhunës në familje, ZMNV në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, ka hartuar dhe aprovuar një formular për deklarimin e dëmeve, i cili mundëson sqarimin e dëmeve të pësura nga viktimat dhe kompensimin e kërkesës duke parashtruar një deklaratë të dëmeve në procedurën penale. Megjithatë, Raporti i Vlerësimit theksoi se nuk ka informacion mbi masën në të cilën dëmet janë kërkuar dhe kompensuar. *Me Kodin e ri Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës* që hyri në fuqi në vitin 2013, avokatët e viktimës kanë edhe rolin e përfaqësimit në gjykatë për të mbijetuarit e dhunës në familje. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të viktimave në emër të tyre. Një zhvillim i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve më të mira për të mbijetuarat e dhunës në familje ka qenë krijimi i dhomave të intervistimit miqësor për fëmijët në shtatë stacione rajonale, të cilat janë mbështetur nga UN Women.

Siç parashikohet në PKBGJ, janë mbajtur trajnime të shumta për personelin e gjykatave, Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore vendore për trajtimin e viktimave të dhunës. Në vitin 2012, në bashkëpunim me MPMS dhe OSBE, në komunat e mëposhtme si Prishtina, Peja, Prizreni dhe Mitrovica, ABGJ ka organizuar trajnime për punonjësit socialë të Qendrave për Punë Sociale dhe ZBGJ-ve në zhvillimin e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarit e dhunës në familje. Në vitin 2014, ABGJ ka mbajtur trajnime në pesë rajone, ku janë trajnuar 256 pjesëmarrës, duke përfshirë: gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit e të mbijetuarve të dhunës në familje, hetuesit policor, përfaqësuesit e drejtorive komunale të arsimit dhe shëndetësisë dhe qendrave ose shërbimeve sociale. MPMS ka hartuar dhe miratuar "Standardet minimale për punonjësit socialë në ndihmën për viktimat e dhunës në familje". Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, gjatë 2013-2014, Ministria ka licencuar të gjithë punëtorët socialë, duke regjistruar këta profesionistë në Regjistrin për Shërbime Sociale dhe Familjare. Që nga viti 2010, UN Women ka mbështetur Institutin Gjyqësor me trajnime për të Drejtësinë Ndërkombëtare dhe nga viti 2011 ka mbështetur organizimin e aktiviteteve të trajnimit të trajnerëve, me qëllim të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke u fokusuar veçanërisht në dhunën në familje, të drejtat pronësore dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e grave.

Një numër i punëtorëve social morën pjesë në trajnime njëditore gjatë vitit 2013 në lidhje me zbatimin e standardeve përkatëse minimale dhe kërkesave ligjore për të ndihmuar të mbijetuarit e dhunës në familje. Në vitin 2013, ZBGJ e Ministrisë së Shëndetësisë, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së, ka organizuar trajnime për 170 punonjës shëndetësorë, në pesë komuna, në temën e shërbimeve të kujdesit të ofruara për të mbijetuarit e dhunës në familje dhe të trafikimit me qenie njerëzore. Në vitin 2012 dhe 2013, Misioni i OSBE-së në Kosovë ofroi trajnime të gjera në përmirësimin e reagimeve ndaj dhunës në familje, duke ofruar trajnime për punëtorët social, avokatët e viktimës, Policinë e Kosovës, punonjësit shëndetësorë dhe shoqërinë civile në nivel lokal, si dhe për zbatimin e PSO-ve. Përveç kësaj, në rajonin e Pejës janë shfaqur gjashtë filma për dhunën me bazë gjinore, një emision në radio me tematikën në fjalë, si dhe trajnimi i personelit mjekësor për mënyrën e trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Pavarësisht këtyre veprimeve, Raporti i Vlerësimit të Programit Kombëtar kundër Dhunës në Familje pretendon se kapacitetet e pamjaftueshme profesionale për të trajtuar rastet e dhunës në familje vazhdojnë të paraqesin një sfidë në trajtimin e plotë të rasteve të dhunës në familje. Gjithashtu, Raporti i Vlerësimit përcakton se nevojat logjistike dhe operative të institucioneve përkatëse për dhunën në familje mbeten një sfidë; ka mungesë të udhëzimeve të qarta për profesionistët që punojnë në fushën e sundimit të ligjit për trajtimin dhe monitorimin e urdhrave të mbrojtjes dhe shkeljet e tyre.

Nuk është bërë asnjë përpjekje e rëndësishme në aktivitetin PKBGJ-së mbi ri-integrimin e grave dhe vajzave të mbijetuara nga dhuna në familje. Duke pasur parasysh varësinë financiare të grave, praktikat diskriminuese sociale dhe tradicionale, si dhe mungesën e shërbimeve të asistencës dhe rehabilitimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje, shpesh të mbijetuarit e dhunës në familje detyrohen të kthehen tek partneri i tyre i dhunshëm.

Megjithëse dokumenti i PKBGJ-së nuk ka paraparë aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me dhunën në familje, është e rëndësishme të theksohet se aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit

për dhunën në familje duhet të bëhen pjesë e përhershme e aktiviteteve vjetore të institucioneve publike të Kosovës gjatë zbatimit të PKBGJ. Në bashkëpunim me ABGJ-në, pothuajse se të gjitha ministritë dhe komunat kanë kontribuar dhe organizuar aktivitete gjatë 16 ditëve të aktivizmit, në baza vjetore. Aktivitetet e kryera në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit për dhunën në familje, kanë shënjestruar publikun e gjerë në zonat urbane dhe rurale, stafin të qeverisë dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal (ministritë, komunat, Qendrat për Punë Sociale, mekanizmat koordinues për dhunën në familje, etj), gratë, nxënësit në të gjitha nivelet e shkollave, grupet e pakicave dhe personave me nevoja të veçanta. Për të rritur shumëfish ndërgjegjësimin janë mbajtur aktivitetet si transmetimi i video klipëve në media elektronike, janë vendosur billborde dhe postera me mesazhe të qarta kundër dhunës në familje; si dhe janë organizuar aktivitete me fëmijë në shkolla; transmetimi i debateve dhe diskutimeve në TV dhe radio stacione lokale dhe kombëtare; tryeza të rrumbullakëta në zonat urbane dhe rurale; seminare në universitete. Në vitin 2012, janë sponsorizuar dy video klipë (një për qasjen e grave në pronë dhe një me temë: “forca fizike nuk e justifikon dhunën ndaj gruas”);

Sfida të tjera të raportuara në raportin e Vlerësimit për dhunën në familje janë edhe këto dy në vijim: a) mungesa e udhëzimeve të qarta për profesionistët që punojnë në fushën e sundimit të ligjit për mënyrën se si të trajtojnë dhe monitorojnë urdhrat e mbrojtjes dhe shkeljet e tyre, të cilëve viktimat duhet t’iu raportojnë në rast të shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes, dhe atë se si policia duhet të merret me këto raste; shkalla e ulët e raportimit të dhunës në familje ndaj fëmijëve, personave të moshuar dhe personave me nevoja të veçanta, kanë mbetur një çështje kritike; dhe b) zbatimi minimal i UA Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psiko-social të kryesit të dhunës në familje dhe UA Nr. 02/2013 për mënyrën e trajtimit të kryerësve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope.

Edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi përhapjen e dhunës në familje, siç paraqitet në shtojcën 1, numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje ka rënë nga 1,371 në 1,089 dhe numri i grave të mbijetuara nga dhuna në familje ka rënë nga 92 në 80 për qind, ose nga 1,261 në 871 raste gjegjësisht. Megjithatë, këto të dhëna si të vetme nuk sugjerojnë përfundimisht se dhuna në familje në Kosovë ka shënuar rënie, pasi mund të ndodh që rastet e dhunës në familje të mos jenë raportuar plotësisht.

Sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore, gjatë zbatimit të PKBGJ u hartuan këto politika: “Plani i veprimit kundër trafikimit 2008-2011”, dhe “Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit kundër trafikimit, 2011-2014”. Më tej, në vitin 2013, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit”. Në të gjitha rastet, dokumentet kanë përfshirë aktivitetet në lidhje me ofrimin e shërbimeve profesionale për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të trafikimit, forcimin e strukturave institucionale dhe trajnimin e personelit të institucioneve përgjegjëse, siç parashikohet në PKBGJ.

Fusha të cilën PKBGJ nuk e ka adresuar gjatë procesit të hartimit dhe e cila nuk referohet qartë, është tema e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Sidoqoftë, vlerësimi arrin në përfundim se në këtë fushë është bërë progres i rëndësishëm gjatë periudhës implementuese të PKBGJ. Siç është raportuar në raportin e parë monitorues mbi implementimin e rezolutës 1325 Gratë, Paqja dhe Siguria, deri në nëntor të vitit 2014 u raportuan rezultate të rëndësishme të cilat duhet të ishin pjesë e procesit të hartimit të kornizës ligjore mbi trajtimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të mbijetuarve civil gjatë luftës/konfliktit, dhunës seksuale, torturave dhe formave tjera të dhunës. Pikat kryesore janë ndryshimi i ligjit nr. 04/-054⁵ me miratimin e ligjit nr. 04/L-172⁶ dhe krijimi me dekret presidencial i këshillit kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Progres i rëndësishëm është bërë edhe në rritjen e ndërgjegjësimit rreth nevojës për të mbështetur të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës/konfliktit; sidomos përmes organizimit të

⁵ Ligji mbi statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

⁶ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre

fushatave të ndryshme ndërgjegjësuere me përfshirjen e shumë sektorëve dhe akterëve, duke filluar nga zyra e presidentit në Kosovë e deri tek OSHC-të. Në vitin 2012, ABGJ ka organizuar një tryezë të rrumbullakët mbi temën “Qasja në drejtësi për gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”, gjatë të cilës janë mbledhur rekomandime mbi sigurimin e kompensimit dhe ofrimin e shërbimeve bazuar në nevojat e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës/konfliktit. Në vitin 2013, me mbështetje të UN Women dhe institutit gjyqësor janë organizuar trajnime për hetuesit, prokurorët, gjykatësit, dhe OSHC për trajtimin e rasteve të të mbijetuarve të dhunës seksuale.

Mund të konkludohet se PKBGJ ka zbatuar me sukses pothuajse të gjitha aktivitetet e përshkruara sa i përket dhunës në familje. Fusha e vetme në të cilën nuk është regjistruar progres ishte ri-intergrimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale. PKBGJ ka përshkruar aktivitete të shumta dhe komplekse të cilat kanalizoheshin përmes *Programit të Kosovës kundër dhunës në familje. Për më tepër gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ, grupi i synuar u zgjerua duke përfshirë kështu edhe viktimat e luftës dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale.*

3.2.4 Stereotipat

Në kuadër të fushës programore të edukimit (Objektivi 2), dy nën-objektiva përfshijnë aktivitetet që pritej të kontribuonin drejt adresimit të stereotipave gjinore në sistemin e edukimit. Nën-objektivi i përcaktuar si “*Përmirësimi i kurrikulave shkollorë që promovojnë barazinë gjinore*” i referohet kryesisht rishikimeve të kurrikulës dhe teksteve shkollorë nga perspektiva e barazisë gjinore, ndërsa nën-objektivi “*Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe programore të MASHT-it për të integruar në mënyrë efektive çështjet e barazisë gjinore në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e objektivave të strategjisë për arsim*” përmban aktivitete mbi ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në largimin e stereotipave gjinore dhe inkurajimin dhe promovimin e barazisë gjinore në shkolla. Institucionet udhëheqëse të identifikuar për arritjen e këtyre objektivave janë të radhitura si në vijim: MASHT, instituti për studime pedagogjike, universiteti i Prishtinës dhe ABGJ.

Vlerësimi konstatoi se bazuar në informatat e gjeneruara nga intervistat, MASHT-i nuk ka kryer një analizë të thellë gjinore të teksteve të tanishme shkollorë, ashtu siç është kërkuar nga PKBGJ. Ky konstatim është konfirmuar edhe nga ZBGJ e MASHT.

Përveç kësaj, në vitin 2011 MASHT ka miratuar *Planin strategjik të arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016*, i cili parasheh që gjatë hartimit të kurrikulave për grup-moshën 0-3, MASHT do të realizoj një kontroll në aspektin gjinorë të kurrikulave të reja gjatë procesit të hartimit me qëllim të shmangies së praktikave të stereotipave gjinore dhe diskriminimit gjinorë. MASHT hartoi “standardet e hartimit të librave shkollorë”, të cilat kërkojnë inkorporimin e perspektivës gjinore dhe aplikimin e treguesve për ndarjen në baza gjinore në procesin e hartimit të librave shkollorë. Gjegjësisht, Standardi 11 i këtij dokumenti fokusohet në barazinë gjinore ekskluzivisht, duke kërkuar që të gjitha tekstet në përgjithësi duhet të kontribuojnë në edukimin e fëmijëve mbi barazinë gjinore dhe në shmangien e diskriminimit me bazë gjinore, si dhe stereotipat gjinore dhe rolet gjinore. Megjithatë, vlerësimi konstatoi se ky standard nuk është zbatuar në praktikë.

Dokumenti i PKBGJ-së parashikon zhvillimin e materialeve ndihmëse për mësimdhënësit në trajtimin e stereotipave gjinore dhe diskriminimit gjatë udhëzimeve në klasë, materialeve ndihmëse mësimore për studentët si dhe trajnime të shpeshta të mësimdhënësve mbi konceptet dhe lëndët e barazisë gjinore. Gjatë vlerësimit, janë bërë përpjekje që të angazhohet Divizioni i Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve në MASHT për të marrë informata në lidhje me realizimin e aktiviteteve të parapara. Megjithatë, Departamenti nuk ofroi asnjë informacion në lidhje me këtë temë. Megjithatë, ZBGJ e MASHT-it ka konstatuar se nuk ka pasur trajnime për mësimdhënësit në korrigjimin e stereotipave gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore.

Një nga aktivitetet e përshkruara në PKBGJ për luftimin e stereotipave gjinore ishte përfshirja e çështjeve gjinore në programin mësimor universitar përmes programeve ekzistuese apo programeve të reja. Gjatë PKBGJ, një modul mbi “Barazinë Gjinore” është futur në programin e Fakultetit të

Edukimit, në Universitetin e Prishtinës, në nivelin bachelor. Gjithashtu, barazia gjinore ishte përfshirë në këto drejtime “Historia dhe Edukata Qytetare” dhe “Gjeografia dhe Edukata Qytetare”. Megjithatë, asnjëri nga këto dy programet nuk është më në funksion. Që nga viti akademik 2014-2015, “Studimet Gjinore” është bërë një lëndë zgjedhore në programin e studimeve “Arsimi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme”.

Ka pasur edhe nisma të cilat nuk ishin parashikuara në dokumentin e PKBGJ-së që janë ndërmarr nga Qeveria e Kosovës për të njohur rolin dhe sakrificat e grave të Kosovës gjatë luftës së viteve 1998-1999. Për shembull, në vitin 2013, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ndërmori iniciativën që të ndërtoj një memorial kombëtar për të nderuar gratë viktime dhe të mbijetuara të luftës së Kosovës. Memoriali u ndërtua në qendër të qytetit. Kjo mund edhe të kontribuojë në trajtimin e stereotipave mbizotëruese për gratë në Kosovë, pasi tregon rolin e grave gjatë luftës, të cilat kanë qenë gjithmonë të përkushtuara për burrat. Megjithatë, ndikimi i veprimeve ad-hoc dhe të izoluar në luftimin e stereotipet dhe rritjen e ndërgjegjësimit zakonisht nuk kanë qenë afatgjata.

Mund të konkludohet se në lidhje me luftimin e stereotipave gjinore, aktivitetet e PKBGJ-së nuk janë zbatuar si dhe nuk ka pasur arritje të rëndësishme që mund të raportohen në këtë drejtim. MASHT-i dhe Universiteti i Prishtinës kanë dështuar në kryerjen e punëve në fushën e autoritetit të tyre institucional dhe përgjegjësisë siç është caktuar nga PKBGJ.

3.2.5 Arsimi

PKBGJ ka synuar të rrisë qasjen e grave dhe vajzave në arsimin cilësor, duke rritur normën e regjistrimit, pjesëmarrjen dhe progresin në arsimin e detyrueshëm. Për më tepër, ai ka synuar të rrisë pjesëmarrjen e grave në mësimdhënie, planifikim dhe menaxhim të institucioneve arsimore dhe të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me rëndësinë e arsimit të grave dhe kontributit të tyre në shoqëri.


Gjatë rrjedhës së PKBGJ-së, janë zbatuar aktivitete të shumta në drejtim të rritjes së regjistrimit, pjesëmarrjes dhe përparimit të vajzave në arsimin e detyruar. MASHT dhe komunat (Viti, Prishtinë, Prizren, Obiliq dhe Suharekë, Klinë, Skenderaj, Dragash, të mbështetura nga ABGJ) kanë mbuluar koston e transportit dhe/ose kanë ofruar bursa (Prishtinë, Suharekë, Pejë) për vajzat me sfond të dobët socio-ekonomik. Gjithashtu, MASHT ka ndërtuar 77 shkolla të reja dhe ka riparuar nëntë shkolla të tjera, që në mënyrë hipotetike kanë çuar në përmirësimin e mjedisit fizik të shkollës dhe sigurisë, edhe pse të dhënat për të vërtetuar këtë deklaratë nuk janë ofruar në këtë vlerësim.

Sa i përket planit për të ofruar trajnime joformale për gratë dhe vajzat, mund të raportohet se gjatë periudhës 2008-2013, një total prej 8,519 grave janë trajnuar nga Qendrat e Aftësimi Profesional (QAP) të drejtuara nga MPMS, dhe 11,459 gra janë punësuar përmes Zyrave Publike të Punësimit të MPMS-së.

Është arritur progres në zvogëlimin e shkallës së analfabetizmit dhe në shkallën e pjesëmarrjes së vajzave në arsim fillor dhe të mesëm, e cila ishte një ndër nën-objektivat e seksionit të arsimit të PKBGJ-së. Statistikat tregojnë se shkalla e analfabetizmit të vajzave të moshës shtatë vjeçare, apo më të mëdha në moshë, është zvogëluar nga 9.1 % (në vitin 2005) në 5.9 % në vitin 2013. Përqindja e grave analfabete në zonat rurale, të moshës mbi 15 vjeçare, është zvogëluar nga 14% në 7.3 %, nga viti 2005 në 2013. Në vitin 2013, 84.4 % e grave të moshës 15-17 vjeçare, janë regjistruar në shkollë të mesme të lartë në krahasim me 71 % në vitin 2005, por përqindja e grave të moshës 25-64 vjeçare, që kanë përfunduar arsimin e lartë ka mbetur e palëvizshme në 8%, e cila është shumë më e ulët në krahasim me normën e burrave (14.3 % në 2013). Progresi i përmendur mund relativisht t'i atribuohet aktiviteteve të ndërmarra nga ABGJ-ja dhe ZBGJ-të e MASHT-it dhe komunat, megjithatë nuk mund të bëhet një lidhje e drejtpërdrejtë për shkak të mungesës së një vlerësimi të elaboruar të aktiviteteve të ndërmarra. Gjithashtu, ABGJ ka mbështetur trajnimet në alfabetin Brail për vajzat dhe gratë e verbra. Të dhënat për trajnimet joformale të zbatuara nga MASHT për luftimin e shkallës së analfabetizmit nuk janë përfshirë në këtë vlerësim.

Për këtë vlerësim është shfrytëzuar indeksi i barazisë gjinore, me qëllim të matjes së qasjes dhe pjesëmarrjes në nivele të ndryshme të arsimit. Ky indeks është një tregues që mat progresin ndaj barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes në arsim, si dhe vë në dukje mundësitë e të mësuarit që janë në dispozicion për gratë në krahasim me burrat (indeksi me vlerë 1 tregon barazinë e plotë gjinore, ndërsa në rastet ku pjesëmarrja e grave është më e ulët reflektohet me vlerat e indeksit të cilat janë më të ulëta se 1). Siç është paraqitur në Figurën 1, në vitin shkollor 2012/13 shihet se vajzat kanë pasur përfaqësim të pamjaftueshëm në arsimin e mesëm të lartë dhe atë parashkollor.

Figura 1: Indeksi i Barazisë Gjinore, viti shkollor 2012/13



Burimi: MASHT, 2015, Raport Statistikor me Treguesit e Arsimit 2012/13 dhe 2013/14.

Segregacioni i profesioneve është theksuar si sfidë në analizën e kontekstit të PKBGJ-së, megjithatë në dokument nuk është paraparë ndonjë aktivitet. Sidoqoftë, është e rëndësishme të raportohet se me qëllim të adresimit të segregacionit të profesioneve, MASHT organizon rregullisht dhe në baza vjetore “Ditën e Vajzave”, e cila përfshin aktivitete për kryerjen e detyrave në punët që tradicionalisht nuk konsiderohen për gratë. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është informimi, ndërgjegjësimi dhe orientimi i vajzave drejt shkollave profesionale në të cilat regjistrimi dhe pjesëmarrja e nxënësve të gjinisë mashkullore vazhdon të mbetet e lartë.

Në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e grave në mësimdhënie, planifikim të arsimit dhe menaxhim të proceseve, PKBGJ ka parashikuar ofrimin e kushteve të favorshme për angazhim e grave në mësimdhënie, planifikim dhe menaxhim si dhe ofrimin e mundësive për avancim të grave të angazhuara në arsim të lartë. Në përgjithësi, sipas të dhënave nga MASHT, ka pasur një progres të vogël në rritjen e përfaqësimit të grave në mesin e mësimdhënësve nga viti 2009 deri në vitin 2013. Në vitin 2009 dhe 2013, në arsimin parashkollor dhe para-fillor të gjithë mësimdhënësët ishin gra (100%), ndërsa përqindja e grave mësuese në arsim të detyrueshëm dhe arsim të mesëm të lartë është rritur vetëm për 4 %. Në arsimin e mesëm të lartë, përqindja e grave mësuese nga viti 2009 deri në vitin 2013, është rritur nga 24% në 40% (MASHT, 2015).

Me qëllim të avancimit të zhvillimit akademik të grave në vitin 2012 dhe 2013, MASHT ka ofruar 58 bursa për studime të doktoratës (PhD), prej të cilave, në vitin 2013 përfituan 13 gra dhe 25 burra. Të dhënat për vitin 2012 nuk janë ndarë sipas gjinisë. Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, MASHT ka mbështetur edhe zhvillim e hulumtimit dhe projektet e mobilitetit. Në vitin 2012 dhe 2013, nga 56 projekte të vogla të mbështetura nga MASHT, 13 janë ndarë për gratë, përkatësisht 23% e tyre. Nga 57 projekte të shkurta të mobilitetit për hulumtues gjatë vitit 2011 deri në 2013, rreth gjysma e projekteve janë ndarë për gratë hulumtuese. Megjithatë, deri në fund të vitit 2013, stafi akademik në institucionet publike ende dominohej nga meshkujt. Sipas institucioneve të arsimit të lartë dhe Agjencisë së Kosovës për Akreditim (raportuar në MASHT 2015, Vlerësimi i PSAK 2011-2016) në

vitin akademik 2012/13, në institucionet publike vetëm 29% ishin gra nga një total prej 1,119 anëtar të stafit akademik të rregullt.

Për të arritur nën-objektivat e ngritjes së ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e arsimit të grave dhe kontributit të tyre në shoqëri, ZBGJ-të e MASHT-it kanë raportuar se janë organizuar aktivitete të ndërgjegjësimit në shkolla, me prindër dhe me komunitetet në zonat urbane dhe rurale. Aktivitetet e parapara për zhvillimin dhe shpërndarjen e manualeve dhe udhëzuesve për barazi gjinore nga perspektiva e mësuesve, prindërve dhe komuniteteve nuk janë zbatuar gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së.

Për ta përmbledhur, gjatë ciklit të PKBGJ-së, pjesëmarrja dhe vijueshmëria e vajzave në arsim të detyrueshëm është përmirësuar, ndërsa pjesëmarrja e grave në menaxhimin e arsimit ka pësuar përmirësime të vogla. Ndërkohë, gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ-së gratë mbeten të nën-përfaqësuara në mesin e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë

3.2.6 Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Për të siguruar pjesëmarrje të barabartë gjinore në pozitat vendimmarrëse, PKBGJ ka përcaktuar katër nën-objektiva, përkatësisht:

- a) zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore 2014 (LBGJ),
- b) harmonizimi i ligjeve të Kosovës me LBGJ-në dhe standardet ndërkombëtare që promovojnë barazinë gjinore në pozitat vendimmarrëse,
- c) zhvillimi i një dokumenti strategjik për rritjen e numrit të grave në pozitat vendimmarrëse nga zonat rurale dhe minoritetet, dhe
- d) nxitja e grave që të marrin pjesë në pozita vendimmarrëse.

Më pas, është raportuar statusi i zbatimit të aktiviteteve, pasuar nga të dhënat mbi progresin e arritur gjatë ciklit të PKBGJ-së.

Në përputhje me planin e PKBGJ-së, ABGJ, ZBGJ-të dhe OSHC-të kanë organizuar evenimente informative dhe ndërgjegjëse për promovimin e kërkesave që rrjedhin nga Ligji për Barazi Gjinore mbi përfaqësimin e grave në pozita vendimmarrëse në institucionet publike. Në vitin 2011, ABGJ ka organizuar një konferencë ndërkombëtare *"Fuqizimi i grave në pozitat vendimmarrëse - rruga e Kosovës drejt Bashkimit Evropian"*. Diskutimet dhe prezantimet janë fokusuar në kornizën ligjore për të ofruar barazi gjinore në pozitat vendimmarrëse dhe në akademi.

Për të rritur avancimin dhe pjesëmarrjen akademike të grave në pozitat vendimmarrëse në shërbimin civil, në vitin 2012 ABGJ ka ndërmarrë një iniciativë për të mbështetur gratë që punojnë në Administratën Publike të Kosovës, duke financuar studimet e tyre para-universitare. Në vitin akademik 2012-2013, është ofruar mbështetje financiare për katër zyrtare të gjinisë femërore.

Në përputhje me aktivitetet e PKBGJ-së, ABGJ-ja, ZBGJ-të komunale, OSHC-të dhe donatorët kanë organizuar aktivitete ndërgjegjësimi mbi rolin e pjesëmarrjes së grave në pozitat vendimmarrëse. Në vitin 2014, ABGJ-ja ka kryer një studim të veçantë për të analizuar gjendjen e pjesëmarrjes së grave në pozitat vendimmarrëse në institucionet lokale dhe qendrore dhe në partitë politike, studim i cili ka identifikuar pengesat për pjesëmarrje të barabartë gjinore në pozitat vendimmarrëse në institucionet dhe parti politike. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve të grave për pozita vendimmarrëse në politikë, e cila më pas mund të rezultojë në pjesëmarrje të ngritur të grave në pozita vendimmarrëse, Iniciativa Demokratike Kombëtare, Konrad Adenauer Stiftung dhe organizata të tjera kanë ofruar trajnime për gratë në politikë, përkatësisht në fushën e udhëheqjes, aftësive të komunikimit politik, marrëdhënieve me publikun, etj. Disa komuna kanë organizuar aktivitete dhe trajnime ndërgjegjësimi për të rritur pjesëmarrjen e grave në pozitat vendimmarrëse në nivelin lokal (përkatësisht Malisheva dhe Klina).

Aktiviteti i planifikuar i PKBGJ-së për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore është realizuar vetëm në vitin 2013 nga *Komisioni i Kuvendit kombëtar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione*. Gjithashtu, ABGJ i ka raportuar rregullisht këtij Komisioni për progresin sa i përket barazisë gjinore në Kosovë dhe sfidat në avancimin e agjendës për barazi gjinore në Kosovë.

Për të siguruar harmonizim të ligjeve ekzistuese me Ligjin për Barazi Gjinore, PKBGJ ka parashikuar harmonizimin e Rregullores së Kuvendit me Ligjin për Barazi Gjinore të vitit 2004, ku gratë do të përbënin 40 përqind të kryetarëve të komisioneve dhe anëtarësisë së tyre. Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë zbatimit të PKBGJ-së dhe vazhdon të mos trajtohet, si dhe nuk është ofruar asnjë shpjegim për moszbatimin e këtij vlerësimi.

Duke krahasuar të dhënat e ofruara në analizën e kontekstit të PKBGJ-së dhe të dhënave të vitit 2013, vërehet progresi i arritur në përfaqësimin e grave në pozitat vendimmarrëse, e cila paraqitet në vazhdim. Në vitin 2014, Presidente e Kosovës ishte zgjedhur një grua dhe në qeverinë e krijuar pas zgjedhjeve të vitit 2010, dy gra kanë shërbyer si Zëvendëskryeministre (nga 5) dhe dy gra si ministre. Në legjislaturën IV (2010-2014), në Kuvendin e Kosovës, i cili përbëhet nga 120 deputetë, kanë qenë 40 gra deputete, kështu duke tejkaluar kuotën e përcaktuar prej 30% të përfaqësimit. Në këtë legjislaturë, 15 gra kanë fituar vendet e tyre si deputete të Kuvendit të Kosovës pa ndihmën e kuotave që përfaqësojnë gati një të tretën e grave të zgjedhura. Në Legjislaturën IV, vetëm 3 nga 13 komisionet e përhershme parlamentare udhëhiqeshin nga gratë, dhe vetëm 29% e anëtarëve në komisione ishin gra (ABGJ, 2014).

Tabela 1 Gratë deputete në zgjedhjet e përgjithshme

	2007	2010	2014
Numri i përgjithshëm i grave deputete	37	40	38
Numri i grave deputete të vetë-zgjedhura (jo për shkak të kuotës)	16	15	18
% e grave deputete të zgjedhura kundrejt të gjitha grave deputete	30%	27%	32%

Burimi: ABGJ, 2014.

Siç paraqitet në Tabelën 2, në vitin 2013, gratë ishin shumë pak të përfaqësuara në pozitat vendimmarrëse si në nivelin qendror, edhe në atë lokal: vetëm 7% e pozitave vendimmarrëse në ministritë e linjës së Kosovës dhe vetëm 4% në komuna mbaheshin nga gratë. Gjithashtu, vetëm 10% e pozitave vendimmarrëse në Policinë e Kosovës janë mbajtur nga gratë. Gratë kanë vetëm 6.3 % të pozitave vendimmarrëse në Forcat e Sigurisë së Kosovës. Bazuar në të dhënat e ofruara, deri në fund të vitit 2014 (ABGJ, 2015: Raporti i parë Monitorues në Zbatimin e Rezolutës 1325 Gratë, Paqja dhe Siguria), gratë përbënin 22% të stafit që shërben në shërbimet e huaja të Kosovës (staf diplomatik dhe konsullor)

Tabela 2: Pjesëmarrja e grave në ministri dhe komuna, në vitin 2013

	% e pozitave vendimmarrëse që mbahen nga femrat	% e pozitave udhëheqëse që mbahen nga gratë
Ministritë	7%	27%
Komunat	4%	19%

Burimi: ABGJ, 2014, të dhënat për vitin 2013

Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, nga 224 kandidatë për kryetarë të komunave, vetëm nëntë prej tyre ishin gra. Gruaja e parë dhe e vetme si kryetare e një komune në Kosovë ishte zgjedhur në vitin 2013.

Me gjithë progresin e shënuar, mund të arrihet në përfundim se neni 3.2 i Ligjit nr. 2004/2 për Barazi Gjinore, në lidhje me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në pozita vendimmarrëse nuk është

vërejtur në nivel qendror dhe lokal, që ishte gjithashtu një nga nën-objektivat e PKBGJ-së në sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në pozitë vendimmarrëse të Kosovës, në të gjitha institucionet publike dhe shtetërore. Neni 3.1 i Ligjit për Barazi Gjinore nr. 2004/2 gjithashtu lejon zbatimin e masave ligjore dhe afirmative për vendosjen e pjesëmarrjes së barabartë për femra dhe meshkuj në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, por nuk janë ndërmarrë veprime të tilla afirmative gjatë ciklit jetësor të PKBGJ-së. Duke pasur parasysh se nuk janë ndërmarrë aktivitete specifike gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së për ta siguruar zbatimin e plotë të Ligjit për Barazinë Gjinore të vitit 2004, nuk është e sigurt nëse progresi i arritur mund të mbahet dhe/apo të avancohet në të ardhmen.

3.2.7 Gratë në media

Analiza e kontekstit të PKBGJ-së vë në pah se mungesa e ndjeshmërisë gjinore në media është evidentuar nga dështimi për t'i eliminuar stereotipet me bazë gjinore që mund të gjenden në organizatat lokale dhe kombëtare publike dhe private të medias. Për t'i luftuar këto probleme të vazhdueshme, PKBGJ-ja në Objektivin 7 që *synon përmirësimin e imazhit të grave në media, kulturë dhe sport*, identifikon dy nën-objektiva: 1) *përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport dhe* 2) *luftimi i stereotipeve gjinore përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave (me orientim gjinor) të mediave dhe produkteve të mediave*.

Problemi kryesor i vënë re gjatë vlerësimit rezulton nga hartimi i kornizës logjike për këtë pjesë, në veçanti aktivitetet e përshkruara dhe që ndërlidhen me nën-objektivat, kryesisht nën objektivin 1, ku janë përshtatur më tepër si rezultate sesa si aktivitete. Për shembull, një nga aktivitetet ishte i përshtatur si në vijim *"Krijimi i hapësirave mediatike për gra të shquara dhe të famshme"*, ndërsa i dyti ishte zgjedhur *"Mbështetja e aktiviteteve të grave me anë të mediave"*, por nuk kishte asnjë shpjegim se si do të arrihej kjo. Mungesa e aktiviteteve konkrete mund të shpjegojë mungesën e progresit në sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave në media.

Gjithashtu, duke pasur parasysh se dokumenti i PKBGJ-së nuk ofronte asnjë informacion mbi gjendjen fillestare, vlerësimi nuk do të mund të nxirrte një përfundim nëse është arritur progres në pozitën e grave gazetarë në krahasim me homologët e tyre meshkuj gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së.

Aktiviteti i vetëm që është zbatuar plotësisht kishte të bënte me kryerjen e një hulumtimi mbi prezantimin e grave në media. Hulumtimi ishte autorizuar nga ABGJ-ja dhe ishte kryer nga një kompani konsulente lokale. Sipas të dhënave nga raporti i vitit 2011 i ABGJ-së *"Prezantimi i Grave në Mediat e Shkruara"*, burrat janë shumë më të pranishëm në media se gratë: 37 për qind e hapësirës ishte dedikuar për gratë në krahasim me 63 për qind për burrat. Vetëm 30 për qind e rasteve të monitoruara përfshinin citate nga gratë dhe vetëm pesë për qind e hapësirës u ishte dedikuar grave në politikë. Në mbulimin mediatik të çështjeve sociale, gratë ishin të përfaqësuara me vetëm 13 për qind të totalit të artikujve të monitoruar, në temat në lidhje me kulturën ato ishin të përfaqësuara vetëm në pesë për qind të mbulimit të përgjithshëm, dhe vetëm katër për qind e mbulimit të lajmeve dhe ngjarjeve sportive ishte dedikuar për pjesëmarrjen e grave në sport. Megjithatë studimi ishte hapi i parë në drejtim të duhur, mund të arrihet në përfundim se nuk ka pasur ndikim në programet dhe politikat e mediave për t'u bërë gjithnjë e më sensitive sa i përket gjinisë dhe për të siguruar mbulimin nga perspektiva e barazisë gjinore.

OSHC lokale janë angazhuar gjithashtu në hulumtime dhe studime të ndryshme gjatë ciklit jetësor të PKBGJ-së. Një studim zbuloi se ishte vënë re një mbulim në rritje i grave gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013 (RrGGK, raporti vjetor i vitit 2013). Gjatë kësaj periudhe, disa kandidatë gra morën mbulim të konsiderueshëm mediatik pa pagesë. Vetë RrGGK ka pasur të paktën 55 raste të mbulimit mediatik në vitin 2013, duke përfshirë edhe televizionin, mediat e shtypura dhe ato elektronike. Edhe kur hapësira ishte ofruar për gratë në media, ato kryesisht paraqiteshin si modele dhe ishin shumë rrallë pjesë e temave si financat, punësimi apo politika (Färnsveden et al., 2014). Në këtë mënyrë, media ka kontribuar drejt ri-afirmimit të mëtejshëm të stereotipave tradicionale gjinore të

maskulinitetit dhe feminitetit (Färnsveden et al., 2014).

Në vitin 2013, Qendra e Mediave e Grave e Kosovës (QMKG), një organizatë e themeluar gjatë periudhës së PKBGJ-së, zhvilloi një hulumtim gjithëpërfshirës mbi pjesëmarrjen gjinore dhe përfaqësimin në media duke futur për herë të parë në Kosovë atë që u krijua vetëm së fundi nga UNESCO, *Treguesit e Ndjeshëm Gjinor në Media*. Sipas rezultateve të hulumtimit të QMKG-së, gratë gazetare të Kosovës punojnë në kushte të ngjashme të punës si homologët e tyre meshkuj dhe se nuk kishte dëshmi për dallim gjinor në paga. Disa produkte të mediave aplikojnë rregullime fleksibile të orëve të punës dhe përgjegjësi në mënyrë të barabartë për burrat dhe gratë ndërsa zhvillimi profesional nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime ka qenë më i theksuar tek gratë. Shumë pak gra gazetare kanë deklaruar se gjinia është faktor përcaktues në vendimin e organizatës së tyre në detyrat e sektorit.

Aktiviteti i parashikuar për zhvillimin e njësive për monitorimin e integritetit të perspektivës gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në media nuk është ndërmarrë. Gjithashtu, nuk ka pasur qasje të unifikuar nga mediat sa i përket aktivitetit të PKBGJ-së për futjen e procedurave për t'i shqyrtuar ankesat e qytetarëve për rastet kur gratë apo burrat janë prezantuar në mënyrë diskriminuese. Siç është raportuar në raportin e QMKG-së të vitit 2013, në shumicën e produkteve të mediave, një letër për redaktorin ishte mekanizmi i vetëm tyre i brendshëm, i zgjedhur për paraqitjen e ankesave dhe kritikave në lidhje me çështjet e barazisë gjinore dhe shumë pak produkte të mediave kanë themeluar Këshillin e Etikës për shqyrtimin e çështjeve të tilla (QMKG, 2013).

Edhe pse nuk janë zbatuar masa të koordinuara për t'i rishikuar kodet etike të gazetarëve për kompensimin e stereotipave gjinore në media, në mënyrë individuale, disa media i kanë futur këto aspekte në kodet etike dhe udhëzimet e tyre (QMKG, 2013).

Për t'i adresuar stereotipat gjinore në media dhe për t'i rritur kapacitetet e gazetarëve janë organizuar disa aktivitete nga ABGJ-ja, RRGK-ja, UNDP-ja dhe OSBE-ja. Për shembull, në vitin 2012, ABGJ-ja në bashkëpunim me UNDP-në dhe OSBE-në, organizuan një ditë trajnime me përfaqësues të mediave mbi raportimin e dhunës në familje me bazë gjinore. Në këtë trajnim u prezantuan dhe u diskutuan me gazetarët Kodi i Etikës dhe standardet profesionale. Në të njëjtin vit, një tryezë e rrumbullakët ishte mbajtur me gazetarë me temën mbi rolin e medias në trajtimin e çështjeve gjinore.

Në përgjithësi, mund të arrihet në përfundim se pak është arritur sipas këtij objekti, pasi vetëm dy nga dhjetë aktivitete të përshkruara janë zbatuar gjatë ciklit jetësor të PKBGJ-së. Prandaj, PKBGJ-ja nuk ka kontribuar në përmirësimin e imazhit dhe përfaqësimin e grave në media, e as nuk ka ndikuar në produktet e mediave që të ndërmarrin veprime në përmirësimin kodit të tyre etik apo që t'i ndryshojnë qasjet në përfaqësimin e grave në media dhe hapësirën e tyre të mbulimit në mediat e shkruara.

3.3 Ndikimi i PKBGJ-së

Sipas udhëzuesit të OBZHE-së, ndikimi i programit mund të vlerësohet duke i adresuar tri pyetje kryesore: 1) *çfarë ka ndodhur si rezultat i PKBGJ-së?* 2) *çfarë ndryshimi real përbën PKBGJ-ja për gratë dhe burrat në Kosovë, dhe;* 3) *sa përfitues janë prekur nga ky program?* Për fat të keq, duke qenë të kufizuara nga disponueshmëria e të dhënave, këto pyetje nuk mund të trajtohen si duhet nga ky vlerësim. Edhe pse nuk është zbatuar plotësisht, mund të thuhet se PKBGJ-ja ka pasur një ndikim të përgjithshëm në promovimin dhe avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. Fushat kryesore të ndikimit të vërejtur gjatë këtij vlerësimi janë si në vijim:

- ngritja e vetëdijes për të drejtat e grave, kornizën ligjore dhe dokumentet ndërkombëtare në lidhje me barazinë gjinore,
- ngritja e vetëdijes në lidhje me rëndësinë e barazisë gjinore në zhvillimin socio-ekonomik të vendit,
- dallimet gjinore në shumicën e treguesve të arsimit janë përmirësuar,
- korniza ligjore kombëtare për dhunën në familje është themeluar në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërsa efikasiteti i institucioneve shtetërore në

- ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës në familje është përmirësuar,
- përmirësime janë shënuar në përfaqësimin e grave në pozita vendimmarrëse,
- deri në fund të vitit 2013, një pjesë e madhe e grave ishin duke udhëhequr biznese private;
- gratë kanë përfituar nga arsimi dhe trajnimi profesional dhe gjithashtu janë udhëzuar në zgjedhjen e profileve studimore të orientuara në aftësim profesional,
- gratë në sport kanë marrë mbështetje nga MKRS-ja, dhe
- statistikën shëndetësore që lidhen me normat e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave janë përmirësuar dhe është siguruar mbështetje për personat me HIV/AIDS.

Siç është prezantuar në fillim të këtij raporti, për këtë vlerësim nuk ishin ofruar të dhënat mbi numrin e grave përfituese nga aktivitetet e realizuara të parapara sipas PKBGJ-së. Prandaj, numri i përgjithshëm dhe grupet e grave si përfituese të drejtpërdrejta nga intervenimet e PKBGJ-së mbetet një gjë e panjohur. Megjithatë, të dhënat e ofruara nga ministritë e linjës, komunat, ABGJ-ja dhe OSHC-të janë raportuar në bazë të seksioneve përkatëse dhe sipas shtojcës 1 të këtij dokumenti. Duhet të theksohet se ka pasur një qasje të kufizuar tek gratë që u përkasin grupeve të pakicave, grave të moshuara dhe grave me nevojë të veçanta. Së përfundim, për shkak të mungesës së studimeve të vlerësimit të ndikimit, nuk ka informacione mbi përfitimet e përfituesve të drejtpërdrejta dhe nuk ka vlerësim të numrit të përfituesve indirekte nga aktivitetet e realizuara gjatë kohëzgjatjes së PKBGJ-së.

Gjatë këtij vlerësimi, është konstatuar se efektiviteti i kufizuar dhe paaftësia për ta matur ndikimin e PKBGJ-së janë të lidhura me shfrytëzimin e dobët të dokumentit të PKBGJ-së gjatë hartimit të intervenimeve. Edhe pse Programi është vlerësuar lartë nga ZBGJ-të, nga diskutimet ishte konstatuar se dokumenti i PKBGJ-së nuk është përdorur si dokument i burimit kryesor nga ZBGJ-të në ministritë e linjës dhe komunat gjatë përgatitjes së planeve vjetore të punës së tyre, në përputhje me aktivitetet e PKBGJ-së. Kjo nga ana tjetër e ka penguar zbatimin e PKBGJ-së. Gjatë intervistave dhe diskutimeve të fokus grupeve, si pengesa qendrore për ta arritur ndikimin e synuar të PKBGJ-së janë identifikuar koordinimi i dobët ndërmjet akterëve përkatës dhe mungesa e monitorimit të PKBGJ-së.

3.3.1 Vlerësimi i strukturave koordinuese dhe sistemeve të monitorimit


Gjatë viteve 2008-2013, përveç ABGJ-së dhe ZBGJ-ve, ka pasur shumë akterë që janë angazhuar dhe kanë punuar në fushat lidhur me gjininë, përfshirë këtu OSHC-të dhe donatorët. Për t'i shfrytëzuar në mënyrën më të mirë burimet financiare të alokuara dhe menaxhuara nga të gjithë akterët konsiderohet i nevojshëm krijimi i një mekanizmi koordinues, i cili nuk ishte paraparë në PKBGJ. Pasi që ABGJ-ja është institucion kryesor për promovimin dhe sigurimin e barazisë gjinore në Kosovë, roli për koordinim i'u caktua Agjencisë për Barazi Gjinore. Megjithatë, gjatë vlerësimit u konstatua se koordinimi në zbatimin e PKBGJ-së ishte i dobët. Kjo vlen për koordinimin brenda institucioneve qeveritare, donatorëve dhe OSHC-ve. Për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet akterëve relevantë, është humbur mundësia që të përshtaten dhe diversifikohen siç duhet intervenimet të cilat do të çonin në rritjen e numrit të përfituesve dhe do të mundësonin trajtimin e sfidave të identifikuara nga PKBGJ-ja. Veç kësaj, nuk ka pasur ndonjë sistem për të siguruar që intervenimet dhe aktivitetet e ndërmarrë kanë qenë në përputhje me objektivat e PKBGJ-së, dhe nuk ka pasur mekanizëm për të monitoruar masat e zbatuara nga donatorët dhe OSHC-të.

Siç është raportuar gjatë këtij vlerësimi, koordinimi i donatorëve në fushën e barazisë gjinore ishte udhëhequr disa vite nga Ambasada e Holandës, dhe si e tillë kishte funksionuar mirë dhe ishte shumë e dobishme në përcaktimin e prioritetëve dhe koordinimin e mbështetjes ndërmjet donatorëve. Megjithatë, që nga pranim-dorëzimi i mekanizmit koordinues tek ABGJ-ja, nuk ka pasur më asnjë koordinim ndërmjet donatorëve. Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, u organizuan vetëm dy takime koordinuese të donatorëve, ku takimi i fundit ishte mbajtur në vitin 2013, e organizuar bashkërisht nga ABGJ-ja dhe Ministria e Integritimit Evropian. Në takimin e fundit u nxjerr një përfundim që ekziston nevojë për koordinim më efektiv në përcaktimin dhe arritjen e prioritetëve.

Sipas të dhënave të siguruar nga Ministria e Integritimit Evropian (MIE), e cila i ruan të dhënat

e Ndhmës Zyrtare për Zhvillim (ODA), gjatë periudhës 2008-2013, mbështetja e donatorëve për kategorinë e çështjeve gjinore arriti vlerën e 19.24 milionë euro (Figura 3). Kontributi më i lartë u regjistrua nga shteti i Luksemburgut dhe ai i Suedisë, 52 dhe respektivisht 20 përqind e mbështetjes totale të donatorëve në këtë kategori. Gjatë vitit 2013, “UN Women” ka ofruar mbështetje financiare për 10 projekte të zbatuara nga OSHC-të e grave në fushën e sigurisë, marrëdhënieve ndëretnike, fuqizimit ekonomik dhe barazisë gjinore. Kontributi i përgjithshëm ishte 280,000 USD.

Figura 3: Mbështetje e donatorëve për kategorinë gjinore, në miliona euro



Burimi: Ministria e Integritimeve Evropiane, nëntor 2016

Megjithatë, marrë parasysh që gjatë periudhës 2008-2013 jo të gjithë donatorët i raportuan kësaj platforme dhe duke ditur se nuk është gjithmonë e lehtë dhe/ose e mundshme të vlerësohet alokimi i fondeve për secilin program dhe projekt në fushën e barazisë gjinore, të dhënat nga kjo platformë ka gjasa të jenë nënvlerësuar (e konfirmuar edhe nga zyrtari i Ministrisë së Financave dhe raporti i RrGGK-së i vitit 2015). Ky studim vuri në dukje se donatorët në mënyrë të zbehtë i përcjellin fondet për barazi gjinore dhe të drejta të grave, dhe shumica e organizatave të grave kanë mungesë të dokumentacionit të duhur dhe raportimit në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin.

Gjithashtu, një tjetër dobësi e PKBGJ-së ishte monitorimi i dobët. Kjo ndodh pjesërisht për shkak se kur ishte hartuar PKBGJ-ja, e njëjta nuk ishte shoqëruar me një mjet të monitorimit, dhe gjithashtu kur ABGJ-ja kishte përgatitur formën, nuk ka pasur ndonjë trajnim apo mentorim mbi përdorimin e këtij mjeti të monitorimit. Rrjedhimisht, ka pasur raportim të standardizuar nga ana e ZBGJ-ve për zbatimin e përditshëm të PKBGJ-së. Si rezultat i kësaj, nuk ka qenë e mundur të ndiqet zbatimi i Planit dhe të identifikohen sfidat që pengojnë progresin. Buletini vjetor informativ i ABGJ-së, është një burim i rëndësishëm i informacionit, edhe pse raportimi lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e PKBGJ-së. Megjithatë ZBGJ-të rregullisht i raportojnë ABGJ-së të dhënat lidhur me barazinë gjinore, këto të dhëna nuk u përdorën për të monitoruar progresin e zbatimit të PKGJ-së për shkak se planet vjetore të ZBGJ-ve nuk u harmonizuan me PKBGJ-në.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se mjeti i monitorimit i PKBGJ-së nuk ishte drejtpërdrejtë i lidhur me monitorimin e progresit të PKBGJ-së dhe i kontekstualizuar me rrethanat e Kosovës në zbatimin e PKBGJ-së. Në dokumentin e PKBGJ-së nuk janë definuar mirë treguesit e nën-objektivave të ndryshme, kurse disa prej tyre nuk ishin as të rëndësishme dhe relevante për rrethanat e Kosovës. Për shembull, njëri nga treguesit lidhej me përfitimet nga papunësia, gjë që nuk ekziston fare në sistemin e mirëqenies sociale në Kosovë. Gjatë zbatimit të PKBGJ-së, nuk janë bërë fare përpjekje për krijimin e treguesve të definuar mirë, ose për rishikimin e atyre ekzistues. Për më tepër, mjeti i monitorimit nuk u projektua në atë formë që të përdoret lehtësisht nga institucionet/partnerët, gjë që do të mundësonte regjistrimin e progresit.

Në bazë të Ligjit 2004/2 për Barazi Ligjore (Neni 4.3), Kuvendi i Kosovës detyrohet që dy herë në vit të shqyrtoj dhe miratoj raportin e Qeverisë së Kosovës mbi zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Megjithatë, nuk ka pasur raportim të veçantë për këtë program gjatë periudhës së zbatimit të tij. ABGJ-ja rregullisht raporton tek Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, por jo në mënyrë specifike për PKBGJ-në. Sipas kryetarit të atëhershëm të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, kërkesa për raportim në Kuvend duhej të ishte bërë nga Komisioni ose grupi joformal i grave deputete të Kuvendit. Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, kryeministri i atëhershëm u ftua vetëm një herë në interpelancë në Kuvend për çështje të progresit të barazisë gjinore.

Për shkak të monitorimit, dokumentacioni dhe raportimit të dobët të PKBGJ-së dhe memories së kufizuar institucionale, nuk ka qenë e mundur të sigurohet kontributi i përgjithshëm financiar nga qeveria për zbatimin e Planit. Përveç kontributit financiar të raportuar në bazë të Nenit 3.2, mund të raportohet se gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) gjatë viteve 2008-2013 ndau 400.000 euro nga të cilat përafërsisht 300.000 për aktivitetet sportive, 12.155 për projektet për të rinj, 13.282 për projektet në fushën e shëndetësisë; 17,124 për mbështetje të OSHC-ve të grave; rreth 5.000 për subvencione për shëndetin e vajzave; 46.000 për projektet e arsimit joformal; 7.000 për projektet që lidhen me sigurinë dhe 2.600 euro për projektet që promovojnë diversitetin kulturor në Kosovë. Të dhënat e mëposhtme financiare janë dhënë nga komunat: gjatë viteve 2008-2013 komuna e Lipjanit dhe ajo e Prizrenit kanë ndarë 15.000 respektivisht 57.000 euro për aktivitetet e lidhura me PKBGJ-në; në vitin 2010 kontributi financiar i komunës së Drenasit për aktivitetet gjinore ishte 10.000 euro.

Megjithëse ABGJ-ja është institucioni kryesor qeveritar për promovim dhe kontribuimin në lidhje me barazinë gjinore, një vëzhgim i rëndësishëm nga ky vlerësim është që Agjencia ka qenë e kufizuar në zbatimin e PKBGJ-së si dhe promovimin dhe orientimin e agjendës së saj. Duket se donatorët kanë projektuar programet e tyre pa u konsultuar dhe koordinuar siç duhet me ABGJ-në dhe pa i përputhur intervenimet e tyre me PKBGJ-në. Marrë parasysh mungesën e të dhënave financiare dhe numrin e përfituesve nga intervenimet e realizuara gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, nuk ishte e mundur të kryhet analiza e kostove dhe përfitimeve, dhe as analiza sa i përket se cilat grupe të grave kanë përfituar më shumë nga ndërhyrjet e realizuara. Siç ishte raportuar gjatë intervistave dhe diskutimeve të grupeve të fokusit, ka pasur një dyfishim të aktivitetëve të institucioneve të qeverisë, donatorëve dhe gjithashtu OSHC-ve. Siç është cekur nga një person i intervistuar 'ka qenë një periudhë gjatë së cilës të gjithë organizonin aktivitete sa i përket dhunës në familje' duke lënë mënjanë sfidat e tjera të mëdha që pengonin promovimin e çështjeve të barazisë gjinore të përcaktuara në PKBGJ.

3.4 Qëndrueshmëria e gjinisë si çështje ndër-sektoriale në politikat publike të Qeverisë së Kosovës

Për të vlerësuar nëse ndikimi i arritur gjatë PKBGJ-së është i qëndrueshëm, në këtë seksion vlerësohet qëndrueshmëria institucionale dhe ajo financiare. Përveç kësaj, gjithashtu rishikohen politikat dhe udhëzimet ekzistuese, përdorimi i statistikave dhe treguesve, konsultimet aktive të akterëve, etj. të cilat kontribuojnë që problemet sa i përket barazisë gjinore bëhen më të dukshme në politikat publike të Kosovës dhe bazat e të dhënave, si dhe analizon dhe shqyrton se a janë ndërmarrë masa pozitive/veprime afirmative gjatë periudhës 2008-2013 të PKBGJ-së, dhe çfarë lloji ndikimi kanë pasur mbi statusin e gruas.

Qëndrueshmëria institucionale

Gjetja kryesore nga ky vlerësim është se në Kosovë ekzistojnë mekanizma për të promovuar dhe kontribuar në barazinë gjinore, edhe në nivel qendror dhe atë lokal, por ekziston edhe një domosdoshmëri urgjente për të përmirësuar kapacitetet e tyre dhe për të krijuar monitorim rigoroz të hartimit të politikave, si dhe sistemeve dhe strukturave të menaxhimit. Është shumë e rëndësishme të sigurohet mbështetja e nevojshme politike për ABGJ-në, ZBGJ-të në ministritë e linjës dhe në nivel

komunal për zbatimin e politikave horizontale të kësaj natyre si PKBGJ-ja.

Gjatë periudhës së PKBGJ-së nuk janë krijuar mekanizma shtesë dhe as nuk janë prezantuar masa afirmative nëpër Ministri. Në disa komuna janë krijuar mekanizmat koordinues për mbrojtjen dhe trajtimin e dhunës në familje. Gjatë fazës së zbatimit të PKBGJ-së, në disa komuna janë krijuar *grupet e grave asambleiste*, të cilët sipas ZBGJ dëshmuar të jenë mekanizma të rëndësishëm në avokimin për të drejtat e grave dhe ndarjen e buxhetit për projektet të cilat kontribuojnë në barazinë gjinore, gjithashtu edhe për zbatimin e PKBGJ-së. Koordinator i Kombëtar për monitorimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje 2011-2014 ka funksionuar mirë, pjesërisht për shkak të presionit të bërë nga komuniteti i donatorëve (deklaratë nga përfaqësuesi ABGJ).

Për të vlerësuar nëse strategjitë kombëtare përfshinin perspektivën gjinore gjatë viteve 2008-2013 është kryer një vlerësim i strategjive të publikuara në uebfaqen e Zyrës për Planifikim Strategjik⁷ të Zyrës së Kryeministrit. Megjithatë, është vërejtur që disa strategji kryesore që lidhen me barazinë gjinore nuk janë përfshirë në këtë uebfaqe, siç është PKBGJ-ja 2008-2013, Plani i Veprimit 2013-2015 për zbatimin e rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria", Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014. Sipas vlerësimit të kryer mbizotërojnë dy vrojtme të përgjithshme:

- së pari, numri i strategjive kombëtare të zhvilluara gjatë periudhës 2008-2013 që përfshijnë perspektivën gjinore ishte i kufizuar, dhe,
- së dyti, strategjitë që përmbushin këtë kusht në disa raste ishin sipërfaqësore dhe nuk përfshijnë objektiva specifike dhe tregues të matshëm për promovimin e barazisë gjinore.

Shtojca 3 nënvizon strategjitë që përmbajnë objektiva specifike gjinore. Vlerësimi konstaton se në *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovës 2011-2016* dhe në Strategjinë për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme përfshihet perspektiva dhe nevojat gjinore në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe më të elaboruar. Është e rëndësishme të theksohet se Doracaku për Përgatitjen e Strategjive Sektoriale, i hartuar në vitin 2013 nga Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit, nuk kërkon përfshirjen gjinore në strategji, dhe si rezultat i kësaj, nuk kërkon që drafti dhe strategjitë e propozuara të rishikohen nga kjo pikëpamje.

Për të siguruar që interesat e grave dhe burrave përfshihen në strategjitë kombëtare duhet të bëhet e detyrueshme një qasje uniforme kundrejt integritit gjinor, në vend se çështjet gjinore të trajtohen nga të ashtuquajturat çështje të ndërlidhura apo programe të veçanta që fokusohen kryesisht tek gratë.

Statistikat, raportet

Nga viti 2008 e në vijim, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rregullisht raportin "*Gratë dhe Burrat në Kosovë*". **Që nga ajo kohë, ASK-ja ka vazhduar hartimin e këtij raporti gjatë zbatimit të PKBGJ-së, pothuajse në baza vjetore. Bazuar në të dhënat administrative dhe ato të sondazheve të bëra, në raport përfshihen të dhëna mbi demografinë; shëndetësinë; arsimin; mbrojtjen sociale; të dhënat gjyqësore; punësimin; të ardhurat; dhe pensionet.**

Në vitin 2014, me mbështetjen e Ambasadës së Suedisë, ABGJ-së, Zyrës së Bashkimit Evropian dhe agjencive të OKB-së u publikua raporti i dytë i *Profilit Gjinor të Kosovës*. Ky profil ofron një analizë të plotë të dallimeve gjinore në të gjitha nivelet sa i përket kuadrit kombëtar, akterëve kyç, sundimit të ligjit, drejtësisë, të drejtave të njeriut, politikave, gjendjes socio-ekonomike, dhunës me bazë gjinore, dhe sektorëve të tjerë.

Gjatë këtij vlerësimi u konstatua se vlerësimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, nga Kuvendi i Kosovës, përkatësisht *Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione* është kryer vetëm një herë gjatë vitit 2013. Për fat të keq, ky raport nuk është shndërruar në një praktikë të rregullt për Kuvendin e Kosovës.

⁷ <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,194>, shikuar më 24 dhe 25 nëntor 2016.

Gjatë zbatimit të PKBGJ-së, në vitin 2012 Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve ka ri-dizajnuar formularin e regjistrimit të bizneseve duke futur një element shtesë të regjistrimit, atë të gjinisë së pronarit. Nga viti 2012, Agjencia Kadastrale e Kosovës përfshin në sistem gjininë e pronarit dhe bashkë-pronarëve të pronës, edhe pse nuk bëhen dallime ndërmjet dy gjinive. Këto përmirësime vetëm mundësojnë që të përcillet progresi i përfshirjes së grave në biznes dhe në pronësi. Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë e kryer në vitin 2013 ofron të dhëna të shëndosha për shumë aspekte, sidomos atyre me rëndësi për të dhënat mbi kushtet shëndetësore dhe jetesës, të ndara sipas gjinisë.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, gjatë diskutimeve me ZBGJ-të në ministri, u konstatua se edhe kur ekzistojnë të dhënat, disa ministri nuk i ndajnë ato sipas gjinisë. Për shembull, edhe pse Objektivi 6.1 i PKBGJ-së kërkon *“rritjen e mbështetjes për familjet e varfra, sidomos atyre me kryefamiljare gra”*, statistikave të rregullta të mbledhura dhe raportuara në fushën e mbrojtjes sociale, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, nuk ofrojnë të dhëna për përfituesit social të ndarë sipas gjinisë së kryefamiljarit ose ekonomisë së shtëpisë.

Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, ABGJ-ja realizoi disa studime kërkimore. Më poshtë janë të listuara ato kryesore:

1. Profili Gjinor i Kosovës, i publikuar në vitin 2008; aktivitet i paraparë në kuadër të PKBGJ-së;
2. Në vitin 2009, me iniciativën e ABGJ-së u ndërmor studimi *“Më shumë se vetëm fjalë”: Përgjigja e organeve të drejtësisë ndaj dhunës në familje*. Ky studim u realizua nga RrGGK dhe u financua nga UNDP-ja dhe Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas;
3. *Gratë në Procesin e Punësimit dhe Vendimmarrjes*, i publikuar në vitin 2011, aktivitet i paraparë në kuadër të PKBGJ-së;
4. *Prezantimi i Grave në Media të Shkruara, 2010-2011*, i publikuar në vitin 2012, aktivitet i paraparë në kuadër të PKBGJ-së, dhe
5. *Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë*, (2014), aktivitet i paraparë në kuadër të PKBGJ-së.

Gjithashtu, gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, studime kanë kryer edhe RrGGK-ja, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, UN Women, QMG, Iniciativa Kombëtare Demokratike, OSBE-ja, UNDP-ja dhe organizata të tjera aktive. Këto studime mund të gjenden në uebfaqet e këtyre institucioneve, por do të ishte e dobishme që të gjitha këto të publikohen në një faqe të veçantë.

Qëndrueshmëria financiare

Gjatë këtij vlerësimi u konfirmua se barazia gjinore ende nuk është në mesin e fushave prioritare të qeverisë dhe si rrjedhojë ka buxhet të kufizuar në dispozicion për aktivitetet dhe intervenimet për promovimin e barazisë gjinore. Mungesa e buxhetit është përmendur vazhdimisht si pengesë në nivelin ministror dhe komunal.

Përkundër kufizimeve financiare, u theksua se ka nevojë për fuqizimin e kapaciteteve të ZBGJ-ve në përgatitjen e projekteve dhe kapaciteteve të ministrive dhe komunave në planifikim, ekzekutim të buxhetit dhe absorbimin e mbështetjes financiare. Për më tepër, meqë komuniteti i donatorëve mbetet një burim i rëndësishëm i financimit, ekziston nevoja për qasje proaktive, përkatësisht ka duhet të formësojë agjendën e saj në vend se sa vetëm ta ndjek atë (RrGGK, 2015).

4. Përfundimet, mësimet e nxjerra/rekomandimet për PKBGJ-në e ardhshëm

4.1 Vërejtjet përfundimtare

Gjetjet kryesore nga ky vlerësim janë paraqitur në vijim:

- PKBGJ-ja ka qenë një instrument i rëndësishëm në adresimin e barrierave për të siguruar avancimin e agjendës së barazisë gjinore në Kosovë,
- Gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së është hartuar legjislacioni i ri, disa strategji dhe mekanizma të cilat kanë kontribuar në nxitjen e mëtejme të vlerave të barazisë gjinore në institucionet e Kosovës dhe publikun e gjerë,
- Mes veprimeve dhe përmirësimeve të shënuara në punësim dhe gjendjen socio-ekonomike të gruas, deri në fund të vitit 2013, gratë ende ishin në një situatë më të pafavorshme në krahasim me burrat,
- Shkalla e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave ka pësuar rënie gjatë periudhës së zbatimit të PKBGJ-së, ndërsa nuk është zbatuar asnjë program për ekzaminimin e kancerit të qafës së mitrës në Kosovë, dhe nuk ka pasur oferta pa pagesë për vaksinim për Human Papilloma Virus (HPV),
- Medikamentet për trajtimin e HIV/ AIDS ofrohen pa pagesë,
- Janë organizuar disa fushata sensibilizuese të pasuar me një rritje në ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të planifikimit familjar në Qendrat e Shëndetit Publik, por vazhdon të ketë mungesë të udhëzimeve adekuata në shkolla për planifikimin familjar,
- Plani për integrimin e perspektivës së barazisë gjinore në kurikulën dhe syllabusin e Fakultetit të Mjekësisë nuk u zbatua kurrë,
- Është arritur progres i dukshëm sa i përket dhunës në familje, që vërtetohet nga:
 - Miratimi i *Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje*,
 - Hartimi i *Programit Kombëtar dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje*,
 - hartimi i *Komentarit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje*,
 - hartimi i *Procedurave Standarde të Operimit*, dhe ofrimi i trajnimeve të shumta për personelin e Policisë së Kosovës, gjyqtarët, punonjësit socialë dhe OSHC-të më sipër,
 - përmirësimi dhe përparimi domethënës në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarit e dhunës në familje, megjithatë, qëndrueshmëria financiare e strehimoreve mbetet sfidë e përhershme,
 - ri-integrimi i të mbijetuarve të dhunës në familje vazhdon të mbetet një sfidë me ndërhyrje dhe kontribute shumë të kufizuara nga qeveria.
- Edhe pse Standardet për tekstet shkollore të MASHT-it kërkojnë që të gjitha tekstet shkollore në përgjithësi duhet të kontribuojë në edukimin e fëmijëve mbi barazinë gjinore dhe në shmangien e diskriminimit në baza gjinore, si dhe stereotipave dhe roleve gjinore, është konstatuar se nga viti 2007, nuk është bërë asnjë analizë e thellë sa i përket barazisë gjinore në tekstet shkollore;
- Në fushën e arsimit programatik, progres është shënuar në uljen e normës së analfabetizmit dhe rritjen e normës së regjistrimit të grave në arsimin e mesëm të lartë.
- Me gjithë progresin e bërë, deri në fund të vitit 2013, treguesit e qasjes dhe pjesëmarrjes në nivele të ndryshme të arsimit nënvizojnë dallimet gjinore, të matura përmes indeksit të barazisë gjinore, duke zbuluar se, vajzat ende janë të nën-përfaqësuara në arsimin e mesëm të lartë dhe parashkollor.
- Në përgjithësi ka pasur progres të vogël në rritjen e përfaqësimit të grave në mesin e mësimdhënësve që nga viti 2009 deri në vitin 2013, përderisa stafi akademik në institucionet publike ende dominohet nga meshkujt.
- Numri i grave që zgjidhen jo për shkak të kuotës gjinore është rritur, si në zgjedhjet kombëtare po ashtu edhe të nivelit lokal,
- Megjithatë, deri në vitin 2013, gratë ishin shumë pak të përfaqësuara në pozitat vendimmarrëse si në nivel qendror po ashtu edhe në atë lokal, meqë vetëm shtatë për qind e pozitive vendimmarrëse janë mbajtur nga femrat në ministri dhe vetëm katër për qind në komuna.

- Grat përbëjnë 10 për qind të pozitive vendimmarrëse në Policinë e Kosovës dhe vetëm 6.3 për qind të pozitive vendimmarrëse në Forcat e Sigurisë së Kosovës;
- Në media, përqindja e grave të punësuar dhe përfaqësimi i tyre në pozita vendimmarrëse dhe si redaktore është ende dukshëm më i ulët krahasuar me burrat. Prania e grave në media është dukshëm më i ulët se ai i burrave. Për më tepër, media në Kosovë ende riafirmon stereotipat tradicionale gjinore dhe mbulimi me lajme mbetet i pa balancuar sa i përket barazisë gjinore,
- Vlerësimi nuk ka arritur të marrë të dhëna mbi buxhetin e shpenzuar nga qeveria për zbatimin e PKBGJ-së dhe të dhënat mbi mbështetjen e donatorëve në fushën e barazisë gjinore ka të ngjarë të nënvlerësohen;;
- Programi u fokusua kryesisht në sfidat me të cilat përballen gratë, duke neglizhuar në mënyrë specifike ato që kanë ndikim te burrat;
- Kosova ka mekanizmat e nevojshëm për adresimin e barazisë gjinore, por me kapacitete të kufizuara për vendosjen, udhëheqjen dhe zbatimin adekuat të agjendës dhe prioriteteve të saja. Ekziston edhe një bazë e mirë e të dhënave të ndara sipas gjinisë për vlerësimin e progresit, edhe pse ende nevojiten përmirësime të mëtejshme në disa fusha (si në shëndetësi). Një numër i kufizuar i strategjive kanë integruar perspektivat e barazisë gjinore dhe të tjerat nuk arritën të përfshijnë tregues që do të siguronin se janë arritur objektivat që gratë dhe burrat përfitojnë në mënyrë të barabartë, dhe
- Koordinimi dhe monitorimi i dobët i PKBGJ-së e ka karakterizuar Programin.
- Mungesa e pronësisë dhe koordinimit të donatorëve dhe OSHC-ve nga ABGJ-ja është përmendur si një pengesë për zbatimin e duhur dhe në kohë të programit.

4.2 Mësimet e nxjerra/rekomandimet për PKBGJ-në e ardhshëm

Në bazë të analizës së PKBGJ-së dhe praktikave më të mira në hartimin e programit dhe strategjive kombëtare, janë nxjerrë rekomandimet e mëposhtme:

- PKBGJ-ja e re duhet ti kushtoj vëmendje të veçantë analizës së kontekstit që do të çonte në identifikimin e sfidave; nga ana tjetër kjo do të shërbejë për përcaktimin e objektivave realiste dhe koherente, dhe për çdo objektiv duhet të planifikohen aktivitetet konkrete. Të gjitha këto elemente duhet të jenë të lidhura në mënyrë të qartë me njëra-tjetrën,
- Të sigurohet që të gjitha sfidat janë të përfshira në PKBGJ,
- Të sigurohet që PKBGJ adreson sfidat me të cilat përballen gratë dhe burrat,
- PKBGJ-ja e re duhet të përmbajë një analizë të kufizimeve/boshllëqeve në kornizën ekzistues ligjore, të cilat janë parakushte për arritjen e objektivave të përcaktuara,
- PKBGJ-ja e re duhet të përfshijë një analizë të shëndoshë të kapaciteteve të mekanizmave institucional përgjegjës për promovimin dhe sigurimin e barazisë gjinore, përkatësisht të akterëve kyç në zbatimin e Programit. Kjo pastaj duhet të shoqërohet me masa të veçanta për përmirësimin e kapaciteteve e nevojshme,
- PKBGJ duhet të i përshtatet qasjes së orientuar në rezultate përkatësisht objektivat, nën-objektivat dhe aktivitetet duhet të jenë specifik dhe të matshëm, duke kontribuar në arritjen e qëllimit të përgjithshëm të programit,,
- Kurdo që është e mundur, treguesit e gjendjes fillestare dhe asaj të synuar duhet të mbështeten në burime zyrtare dhe të rregullta të të dhënave, dhe jo në dëshmi nga hulumtimet ad hoc. Në rastin e kësaj te fundit, duhet të sigurohet përshkrimi i qartë i llogaritjes së treguesve,
- Indikatorët duhet të përcaktohen duke ndjekur qasjen SMART, pra duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe me afate kohore,
- Për secilin aktivitet, buxheti duhet të llogaritet me informacion të qartë mbi llogaritjen,
- Për secilin aktivitet, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse duhet të definohen dhe të caktohen, duke marrë në konsideratë fushat e tyre të autoritetit dhe mandatin,
- Mjete të thjeshta, por gjithëpërfshirëse të monitorimit duhet të shoqërojnë PKBGJ e re, dhe duhet të ofrohen trajnime adekuate për zbatimin e mjeteve, për të gjithë ZBGJ-të dhe të gjithë partnerët implementues,
- PKBGJ-ja e re duhet të parashikojë mekanizmat koordinues, me ABGJ që e kryeson strukturën dhe procesin koordinues. Kjo duhet të shërbejë si një instrument që siguron se ndërhyrjet ndërmerren duke ndjekur rendin e prioritetit, duke siguruar që janë bërë përparime në të gjitha fushat e PKBGJ-se dhe ruajtjen e përdorimit efikas të burimeve, dhe
- PKBGJ e re duhet të përmbajë një afat kohor për raportim të rregullt në Kuvendin e Kosovës, mbi progresin e arritur.

Referencat

- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), 2011, Gratë në Procesin e Punës dhe Vendimmarrjes: <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Raportit%20i%20hulumtimt%20'Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20procesin%20e%20punes%20dhe%20Vendimarrjes%20'shqip%20A5%20-%2088%20faqe.pdf>
- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), 2014, Pjesëmarrja, Roli dhe Pozita e femrës në institucionet qendrore dhe lokale dhe në partitë politike.
- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), 2012, Prezantimi i Grave në Mediat e Shkruara: 2010-2011: <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ-Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20Mediat%20e%20Shkruara%20%202011-20012.pdf>
- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), Buletinet 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, në dispozicion në: <http://abgj.rks-gov.net/sq-al/publikimet.aspx>
- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), 2014, Raporti i parë monitorues i Planit të Veprimit në Zbatim të Rezolutës 1325 'Gratë, Paqja dhe Siguria' 2013-2015: në dispozicion në <http://abgj.rks-gov.net/LajmetAdmin/tabid/81/articleType/ArticleView/articleId/316/language/sq-AL/ABGJ-Raporti-i-pare-monitorues-i-PV-ne-Zbatim-te-Rezolutes-1325.aspx>
- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), 2016, Raporti i dytë monitorues i Planit të Veprimit në Zbatim të Rezolutës 1325 'Gratë, Paqja dhe Siguria' 2013-2015: në dispozicion në <http://abgj.rks-gov.net/LajmetAdmin/tabid/81/articleType/ArticleView/articleId/316/language/sq-AL/ABGJ-Raporti-i-pare-monitorues-i-PV-ne-Zbatim-te-Rezolutes-1325.aspx>
- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), 2008, Profili Gjinor i Kosovës, <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/PROFILI%20GJINOR.pdf>
- Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), 2010, Një Udhërfyes për Monitorimin dhe Vlerësimin e Politikave dhe Programeve nën Këndvështrimin Gjinor, Program i Kosovës për Barazi Gjinore: Matja e Qeverisjes Demokratike.
- BIRN, 2013, Problemet dhe te Metat e Teksteve Shkollore (Problems and Weaknesses of the Text Books: Analysis of textbooks of grae 6,7,8, and 9 of lower-secondary education): ne dispozicion ne : http://jetanekosove.com/repository/docs/Tekstet_ANALIZA_shqip_339320.pdf
- Dokument Pune i Personelit të Komisionit Raporti Progresit 2013 Për Kosovën Në Përcjellje të Dokumentit Komunikata nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf
- Färnsveden, U., Qosaj-Mustafa, A. dhe Farnsworth, N., 2014, Profili Gjinor i Kosovës: http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_20757/cf_347/Orgut_Kosovo_Gender_Profile_FINAL_2014-05-08.PDF
- Gashi, A. dhe Rizvanolli, A, 2015, The Cost of Patriarchy Excluding Women from the Workforce is the Main Bottleneck to Development, D4D: https://rs.boell.org/sites/default/files/2015-02-16-inactivity_web.pdf
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2013, Rezultatet e Anketës së fuqisë punëtore 2013 në Kosovë: <http://www.unkt.org/wp-content/uploads/2016/08/929120REVISED00vey02013000ENG000WEB.pdf>
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2011, Ndikimi i Ligjit të Punës tek Gratë në Kosovë.
- RrGGK, 2013, Ku janë paratë për të drejtat e grave?, Rast studimi për Kosovën.
- RrGGK, 2009, Raportet vjetore 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, ne dispozicion ne at: <http://www.womensnetwork.org/?FaqeID=13>
- RrGGK, 2009, Më shumë se vetëm fjalë në letër: Përgjigjja e organeve te drejtësisë ndaj dhunës ne familje ne Kosove R', ne dispozicion ne: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130204170726792.pdf>
- RrGGK, 2015, Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë, Analize e përgjithshme e shpenzimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë : ne dispozicion ne <http://www.womensnetwork.org/documents/20160607151528942.pdf>
- MASHT, 2015, Raport Statistikor me tregues arsimorë 2012/13 dhe 2013/14.
- MASHT, 2016, Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim: ne dispozicion ne <http://masht.org>

rks-gov.net/uploads/2016/08/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-shq.pdf, 3 nëntor 2016.

MASHT, 2016, Draft: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, i pa publikuar.

Ministria e Drejtësisë, 2015, Raporti mbi Vlerësimin e Strategjisë së Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014.

MPMS, 2014, Puna dhe Punësimi: Raporti vjetor i vitit 2013.

NDI, 2015, Kosovë: Tejkalmi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë.

UN Women, 2015, Establishing and Strengthening an Association of Women Police the Case of the Association of Women in Kosovo Police.

UNFPA, 2014, Kosovo Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014: ne dispozicion
https://mics-surveysprod.s3.amazonaws.com/MICS5/Central%20and%20Eastern%20Europe%20and%20the%20Commonwealth%20of%20Independent%20States/Kosovo%20under%20UNSC%20res.%201244/2013-2014/Final/Kosovo%20%28UNSCR%201244%29%202013-14%20MICS_English.pdf.

UNFPA, 2016, Gender Bias in Kosovo: available at
<http://www.unfpakos.org/wp-content/uploads/2016/10/Gender-bias-in-Kosovo-2.pdf>.

Qendra e Mediave të Grave (WCMK), 2014, Media dhe Gjinia.

Shtojca 1: Treguesit të gjendjes fillestar dhe përfundimtare të PKBGJ-së: Treguesit e gjendjes fillestare të nxjerrë nga analiza e kontekstit të Programit

Treguesit	Viti referues	Burimi	Treguesit	Viti i referencës	Burimi
Qasja e grave dhe vajzave në arsimin cilësor					
9.1% e vajzave të moshës 7 vjeçare apo më shumë që nuk lexojnë dhe shkruajnë	2005	ABEF; ASK	5.9% e vajzave të moshës 7 vjeçare apo më shumë nuk dinë të lexojnë dhe shkruajnë	2013	ASK, ABEF 2013
14% e vajzave mbi moshën 15 vjeçare që jetojnë në zonat rurale janë analfabete	2005	ABEF; ASK	7.3% e vajzave mbi moshën 15 vjeçare që jetojnë në zonat rurale janë analfabete	2013	ASK, ABEF 2013
71% e femrave regjistrohen në shkollë të mesme, krahasuar me 84.4% të meshkujve	2005	ABEF; ASK	84.4% e vajzave të moshës 15-17 vjeçare janë të regjistruara në shkollë të mesme në krahasim me 89.4% të meshkujve: Duke iu referuar normës së tranzicionit sipas treguesve nga arsimi i ulët në të mesëm, 8.8% e femrave nuk regjistrohen në arsim të mesëm në krahasim me 1.2% të meshkujve.	2013	MASHT, 2015, Raporti statistikor me tregues në arsim 2012/13 dhe 2013/14
Vetëm 8% e grave të moshës mes 25-64 kanë përfunduar arsimin e lartë në krahasim me 23% të meshkujve	2002	Sondazhi i Riinvest për tregun e punës	8% e grave të moshës mes 25-64 kanë përfunduar arsimin e lartë në krahasim me 14.1% të meshkujve	2013	ASK, ABEF 2013
Distanca për në shkollë: të rriturit mbi moshën 16 vjeçare të zonave rurale, mesatarisht udhëtojnë 18 kilometra për të arritur në shkollë	2002	Sondazhi i Riinvest për tregun e punës	Nuk ka të dhëna		
Qasja dhe shërbimet shëndetësore cilësore për gratë dhe vajzat					
Shkalla e vdekshmërisë së nënave në vitin 2006 ishte 7 në 1000	2006	Raporti 'Gjendja perinatale në Kosovë në vitet 2000-2006'	Nuk ka vdekje të nënave gjatë lindjes dhe brenda 40 ditëve nga data e lindjes		

Treguesit	Viti referues	Burimi	Treguesit	Viti i referencës	Burimi
Vdekshmëria e foshnjave në vitin 2006 ishte 23 në 1000. Më e lartë për vajzat. Në vitin 2008 shkalla e vdekshmërisë foshnjave të gjinisë mashkullore ishte 11.1 kurse e femërore 9.0 (FPKB, 2016)	2006	Raporti 'Gjendja perinatale në Kosovë në vitet 2000-2006'	Shkalla e vdekshmërisë foshnjore e djemve është 10.7 kurse e vajzave 9.0	2013	FPKB, 2016, Njëanshmëria gjinore në Kosovë
Abortimi selektiv d.m.th aborti i vajzave	Nuk ka të dhëna			Shkalla e vdekshmërisë foshnjore e djemve është 10.7 kurse e vajzave 9.0	FPKB, 2016, Njëanshmëria gjinore në Kosovë
Fuqizimi ekonomik i grave					
Spektori i punësim-it: 85% e femrave të punësuar në sektorin e shërbimeve; 8% në industrinë dhe tregtinë e rëndë dhe 6% në bujqësi.	2004	RZHNJ5: UNDP	Femrat kryesisht janë të punësuar në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë (rreth 40% e grave të punësuar); 6.1% në prodhim, 7.6% në bujqësi.	2013	ASK, AFP
Pronësia e bizneseve: vetëm 6.5% e bizneseve janë në pronësi të grave: Synimi: 20%	2002	ASK, nuk ka referencë apo sondazh për të raportuar	14% e ndërmarrjeve kanë pasur gra në mesin e pronarëve kryesorë	2014	ASK, Gratë dhe burrat
Nga 500 NVM vetëm 2% janë në pronësi të grave. Synimi 15%	2004	MTI: nuk ka referencë apo sondazh për të raportuar	13% e NVM-ve në pronësi të grave kurse 3% në bashkëpronësi të grave	2014	KIESA (2014): Raporti për NVM-të në Kosovë 2014
99% e ndërmarrësve grave udhëheqin mikro-ndërmarrje dhe ndërmarrje individuale	2004	MTI: nuk ka referencë apo sondazh për të raportuar	Pothuajse 99% e bizneseve janë mikro-ndërmarrje.	2014	KIESA (2014): USAID, 2014, Raporti mbi NVM-të në Kosovë 2014: Barazia gjinore në analizën e sondazhit të Opinionit Publik të Tregtisë

Treguesit	Viti referues	Burimi	Treguesit	Viti i referencës	Burimi
Përmirësimi i situatës sociale të grave në rrezik					
Normat e varfërisë: Synimi: deri në vitin 2015, reduktimi me 50% të numrit të njerëzve që jetojnë në varfëri të skajshme			Shkalla e varfërisë në familjet me kryefamiljare femra në vitin 2013 ishte 18.4%. 18.2% e grave jetojnë në varfëri absolute	2016	ASK, 2016, Raporti i varfërisë 2012-2015
Punësimi për gratë dhe vajzat					
Pjesëmarrja e vajzave në fuqi punëtore është 26.9%	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	21.10%	2013	Sondazhi i ASK-së mbi AFP-në
68.9% e grave janë të papunësuar	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	38.80%	2013	Sondazhi i ASK-së mbi AFP-në
8.4% e grave janë të punësuar	2003	Banka Botërore: Studimi i Tregut të Punës	12.90%	2013	Sondazhi i ASK-së mbi AFP-në
Gratë përbëjnë 56% të punësimit në sektorin e administratës publike	2008	Raportuar nga ABGJ	Gratë përbëjnë 39% të punësimit në ministri (përfshirë agjencitë) dhe komunitat	2014	Profili gjinor 2014
Vetëm 17% e grave mbajnë pozita drejtuese në sektorin privat	2008	Raportuar nga ABGJ	Gratë kosovare përbëjnë vetëm 0.3% të menaxherëve të lartë në kompanitë private	2014	USAID, 2014
Paga mesatare e grave është 180 euro, krahasuar me 203 euro të meshkujve	2003	Banka Botërore: Studimi i Tregut të Punës	Paga mesatare kombëtare në Kosovë është 349 euro, sipas AFP-së nuk ka ndryshime të mëdha në mes të pagave të grave dhe të burrave në Kosovë	2013	ASK, Rezultatet strukturore të anketave biznese 2014.
Përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport					
43.5% e të punësuarve në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve janë femra		Tregues të varfër	44.5% e të punësuarve në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve janë femra	2013	Profili gjinor 2014
Redaktore në media	Nuk ka të dhëna	Janë përmendur si relevant			
Pjesëmarrje dhe përfaqësim i barabartë i të dyja gjinive në proceset e vendimmarrjes.					

Treguesit	Viti referues	Burimi	Treguesit	Viti i referencës	Burimi
10% e pozitive mbikëqyrëse në administratën publike janë femra.	2008		23% në pozita vendimmarrëse në ministri;	2013	Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, 2013
35.6% e të punësuarve në institucionet qendrore dhe lokale janë femra.	2008		28% e të punësuarve në institucionet qendrore dhe lokale janë femra	2013	Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, 2013
25% e pozitive mbikëqyrëse në komuna janë femra.	2008		33% e pozitive mbikëqyrëse/vendimmarrëse nëpër komuna janë femra.	2013	Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, 2013
2 komisione parlamentare udhëhiqen nga femrat	2008		3 nga 4 komisionet të përhershme udhëhiqen nga femrat; 1 nga 8 komisionet funksionale udhëhiqen nga femrat	2013	Profili gjinor 2014
28% e ulëseve në kuvendet komunale janë femra.	2008		34% e ulëseve në kuvendet komunale janë femra.	2013	Profili gjinor 2014
2 gra ministre	2008		1 femër ministre (nga 18 ministra)		Profili gjinor 2014
1 sekretare në ministri	2008		1 Sekretare e Përgjithshme në një Ministri	2013	
25% e gjyqtarëve janë femra	2008		27.3% e gjyqtarëve janë femra	2013	Gratë dhe burrat 92013)
17% e prokurorëve janë femra	2008		35.5% e prokurorëve janë gra	Mars-14	Profili gjinor 2014
15% e KPK-së janë femra	2008		20% e personelit me uniformë të PK-së; 18.5% e personelit të përgjithshëm të PK-së	2013	Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, 2013
Përmirësimi i situatës sociale të grave në rrezik					
1,371 raste të dhunës në familje; 92% janë gra, fëmijë, prindër	2006	Policia e Kosovës	Nga 1,089 raste të raportuara të dhunës në familje, 80% e të mbijetuarve ishin femra	2013	Profili gjinor 2014

Shtojca 2: Lista e personave të intervistuar

Emri dhe mbiemri	Institucioni	Pozita
Edi Gusia	Agjencia për Barazi Gjinore	UD Kryeshef Ekzekutiv
Leonora Selmani	Agjencia për Barazi Gjinore	Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore
Bujar Uka	Agjencia për Barazi Gjinore	Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Raportim
Adelina Loxhaj	Agjencia për Barazi Gjinore	Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim
Adelina Sokoli	Ministria e Infrastrukturës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Florentina Saliu	Ministria e Integritimit Evropian	Zyrtare për Barazi Gjinore
Fahri Restelica	Agjencia për Barazi Gjinore	Zyrtar i Lartë për Informim
Zyrafete Murati	Ministria e Administratës Publike	Zyrtare për Barazi Gjinore
Fatime Jasiqi	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	
Nazmije Kajtazi	Ministria e Shëndetësisë	Zyrtare për Barazi Gjinore
Asrije Bajgore Fetahu	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Besa Qirezi	Ministria për Kthim dhe Komunitete	Zyrtare për Barazi Gjinore
Sebahate Shala	Agjencia për Barazi Gjinore	Zyrtare e Financave
Hasnije Bardhi	Ministria e Financave	Zyrtare për Barazi Gjinore
Shpresa Sheremeti	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Zyrtare për Barazi Gjinore
Fahrije Qorraj Kaloshi	Ministria e Energjisë	Zyrtare për Barazi Gjinore
Ferinaze Isufi	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Zyrtare për Barazi Gjinore
Kadrije Myrtaj	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Zyrtare për Barazi Gjinore
Venera Dibra	Ministria e Punëve të Brendshme	Zyrtare për Barazi Gjinore
Florentina Beqiraj	Ministria e Drejtësisë	Zyrtare për Barazi Gjinore
Remzie Maloku	Komuna e Klinës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Amir Bushi	Komuna e Hanit të Elezit	Zyrtar për Barazi Gjinore
Ibadete Rexhepi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Sebahate Qorkadiu	Komuna e Pejës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Habibe Bytyqi	Komuna e Suharekës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Lindita Dervisholli Prebreza	Komuna e Fushë Kosovës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Sadbere Vllasaliu	Komuna e Novobërdës	Zyrtare për Barazi Gjinore
Milena Bascarevic	Komuna e Zubin Potokut	Zyrtare për Barazi Gjinore
Lindita Kozmaqi Piraj	Komuna e Dragashit	Zyrtare për Barazi Gjinore
Gjyste Dabaj	Komuna e Lipjanit	Zyrtare për Barazi Gjinore
Visare Mujko Namani	FPKB	Specialiste e programit, OIC
Suzana Noveberdaliu	Kuvendi i Kosovës - Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	Ish-Kryetare e Parlamentit
Flora Macula	UN Women	Drejtoresh e UN Women, Kosovë
Igballe Rogova	Rrjeti i Grave të Kosovës	Drejtoreshë Ekzekutive

Shtojca 3: Objektivat lidhur me barazinë gjinore në dokumentet strategjike kombëtare të zhvilluar/ mbulojnë periudhën 2008-2013

Titulli i strategjisë	Periudha e mbuluar	Institucioni udhëheqës	Fusha në të cilën synohet barazia gjinore	Objektivat strategjike të fokusuar në gjini
Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë	2011-2016	MASHT	Arsim	Në vitin 2016, 90% e mësuesve kanë ripërtërirë licencën, ndërsa 5-10% janë promovuar në një nivel më të lartë duke siguruar barazi gjinore dhe paritet; Në vitin 2016 MASHT-i në bashkëpunim me KKK ka certifikuar dhe licencuar trajnerët e programeve për ZHPM (përzgjedhja e trajnerëve balancohet sipas aspektit gjinor); Projektimi dhe akreditimi i programit të udhëheqjes dhe trajnimit të menaxhimit është i drejtë dhe i balancuar në bazë të aspektit gjinor; Përditësimi dhe projektimi i kurrikulave në bazë të orientimit gjinor; Organizimi i trajnimeve mbi udhëheqjen dhe menaxhimin për stafin e MASHT-it dhe të DKA-ve, si dhe për drejtorët e shkollave, me parime të barazisë dhe balancimit nga aspekti gjinor; Deri në vitin 2016 pjesëmarrja e grup-moshës 18-25 në arsim të lartë ka arritur në 35% duke respektuar barazinë gjinore; Në vitin 2014 ka pasur mbështetje të vazhdueshme dhe mundësi të barabarta për përfshirje në arsim të lartë për të gjithë pa dallim të: etnicitetit, gjinisë, moshës, fesë, nevojave të veçanta arsimore dhe grupeve tjera sociale.
Strategjia Kosovare për Rininë	2013-2017	MKRS	Arsim	Nën: Integrimin Shoqëror, Vullnetarizmi, Sporti, Kultura dhe Rekreacioni, parashihet që «Shkëmbimi i përvojave mes artistëve të rinj dhe sportistëve-sportistëve duhet të mbështetet në nivel ndërkombëtar, në mënyrë që të rinjtë e Kosovës të mund të bëhen pjesë e rinisë dhe proceseve ndërkombëtare» dhe “Të përfshihen të rinjtë e zonave rurale dhe vajzat me mundësi të kufizuara (të vogla) në aktivitete ekonomike dhe shoqërore’.

Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë	2012-2016 me vizion të vitit 2020	MTI	Fuqizimi ekonomik	Sipas Qëllimit Strategjik 7, Strategjia ka planifikuar aktivitete për përmirësimin e pozitës së femrave ndërmarrëse, duke përfshirë: rritjen e qasjes së femrave ndërmarrëse në Skemën "Voucher"; projektimin e objekteve investuese për femrat ndërmarrëse; promovimin e programeve përkrahëse për të inkurajuar sipërmarrëset femra, në mënyrë që të krijohen ndërmarrje të reja dhe të rritet numri i tyre; projektimin e programeve të specializuara të trajnimit; zhvillimin e shembujve të përvojave të mira afariste të femrave ndërmarrësve; rritjen e rrjeteve (bashkëpunimit) në mes të femrave ndërmarrëse dhe grupeve të tjera; ofrimin e mundësive financiare; hartimin e politikave specifike të cilat synojnë mbështetjen për femrat sipërmarrëse; dhe zhvillimin e inkubatorëve të biznesit për sipërmarrëset femra.
Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve në Kosovë	2011-2016	MPMS	Parandalimi i punës së fëmijëve Arsimimi	Të sigurohet përfshirje dhe arsim gjithëpërfshirës duke: trajtuar nevojat e grupeve të përjashtuara sociale të fëmijëve, veçanërisht sa i përket qasjes së tyre në arsim, duke trajtuar probleme të veçanta me të cilat ballafaqohen vajzat, për shembull duke futur masa për të minimizuar ndërveprimet mes të shkollimit dhe të aktiviteteve shtëpiake, duke reduktuar distancën e udhëtimit të bërë nga fëmijët e vegjël për në shkollë (ose duke siguruar transport të sigurt), duke siguruar mjedise të përshtatshme (p.sh. tualete) për vajzat.
Strategjia Kombëtare për të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara	2013-2023	Zyra e Kryeministrit	Mirëqenia dhe sistemi i sigurimeve shoqërore	Objektivi Strategjik 2: Mirëqenia dhe sistemi i sigurimeve shoqërore funksionale dhe të mirëfillta, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Me këtë parim objektivi strategjik thekson se Mbrojtja Sociale mbështet të gjithë personat në nevojë, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Kjo e drejtë dhe nevojë është më e pranishme në mesin e personave me aftësi të kufizuara, dhe në mënyrë të veçantë tek gratë dhe të moshuarit me aftësi të kufizuara, dy kategori të cilat konsiderohen si më të rrezikuarat në shoqëri.

